

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5446
E hënë, 9 prill 2018
çmimi 0.40 €

Tahiri: Serbisë nuk i intereson Asociacioni, por ndryshimi i kufijve | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE", FLAMUR HYSENI | FAQE 4-5

Kushtetuta duhet të plotësohet me disa kapituj

Profesori universitar i së Drejtës, Flamur Hyseni, ka thënë se Kushtetuta e Kosovës ka nevojë të plotësohet me disa kapituj në të ardhmen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", me rastin e shënimit të dhjetëvjetorit të Kushtetutës, Hyseni ka thënë se akti më të lartë juridik të vendit duhet t'i shtohet kapitulli që ka të bëjë me konstitucionalizimin e partive politike dhe kapitujt që


ndërlidhen me integrimet euroatlantike. Po ashtu, Hyseni ka shprehur edhe nevojën e ndryshimit të mënyrës së zgjedhjes së presidentit. Sipas tij, shefi i shtetit duhet të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli. Hyseni ka pohuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008, ka arritur të realizojë dy qëllime kryesore: konstituimin e institucioneve themelore shtetërore dhe fillimin e procesit të transformimit të shumë segmenteve shoqërore

AKR-ja këtë javë do të dalë me emrin e ministrit të Punëve të Brendshme

Sekretari i përgjithshëm i Aleancës Kosova e Re (AKR), Vesel Makolli, shprehet se këtë javë do të emërohet ministri i Punëve të Brendshme. Ai ka thënë për

gazetën "Epoka e re" se aktualisht nuk ka ndonjë emër konkret për këtë pozitë por, sipas Makollit, strukturat e partisë janë duke u angazhuar për ta përzgjed-

hur njeriun e duhur. Pavarësisht prej zhvillimeve të fundit politike në vend, ai ka theksuar se AKR-ja nuk është për prishje të koalicionit qeverisës



Në morgun e Prishtinës janë 300 mbetje mortore

Në Institutin e Mjekësisë Ligjore (ILM) janë mbi 300 mbetje mortore, të cilat datojnë nga Lufta e

Parë Botërore e deri në luftën e vitit 1999 në Kosovë, e që nuk janë identifikuar ende se kujt i përkasin

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

FEJA DHE INTEGRIMI I KOSOVËS NË BE

F. 6
Nga Mimoza
KELMENDI



LIDERËT UROJNË BESIMTARËT ORTODOKSË PËR PASHKËT

F. 6

ISH-KRYEMINISTRI MUSTAFA KTHEHET NË KOSOVË

F. 7

EKONOMI

MINISTRIA E FINANCAVE, REFORMA TË MËDHA NË TATIME

F. 9

REÇICA: TË RINJTË TË BËHEN PJESË E TREGUT TË PUNËS PËRMES QAP-it

F. 9

KULTURË

NJË ZË THIRRJE PËR ZGJIMIN, PAJTIMIN DHE BASHKIMIN KOMBËTAR TË SHQIPTARËVE

F. 13

Riza GREIÇEVCI

SPORT

FITOJNË LLAPI DHE VËLLAZNIMI, DRITA NUK E LËSHON KREUN

F. 15

'PAQE' NË DERBIN E MADRIDIT

F. 15

Policia nis procedim penal kundër Bashës dhe Kryemadhit



Pas protestës së fundit të opozitës shqiptare për mosbindje civile, si formë kundërshtimi ndaj politikave të qeverisë për rritjen e taksave, Policia shqiptare ka nisur procedimin penal për disa deputetë të opozitës

TIRANË, 8 PRILL - Policia shqiptare ka nisur procedimin penal për disa deputetë të opozitës, përfshirë kërret e saj për bllokimin e disa akteve kombëtare. Bëhet fjalë për protestën më të fundit të udhëhequr nga opozita shqiptare nën moton e të ashtuquajturës mosbindje civile, si formë kundërshtimi ndaj politikave të qeverisë për rritjen e taksave, përfshirë taksën në rrugën e kombit. Sipas policisë, personat e proceduar janë Lulzim Basha, Xhelal Mziu, Nard Ndoka, Luan Rama, Flamur Noka, Monika Kryemadhi, Edmond Spaho dhe të tjerë janë proceduar si organizatorë të tubimeve të paligjshme, të kryera në Vorë, Milot, Pogradec etj.

Akuzat e ngritura ndaj personave të proceduar janë "Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime dhe manifes-

time të paligjshme", "Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit" dhe "Prishja e qetësisë publike" dhe "Ndotja e ajrit".

Konkretisht, sipas policisë, për protestën në rrethrotullimin e Vorës në autostradën Tiranë - Durrës u proceduan tetë persona.

Për protestën në aksin Mamurras - Milot policia procedoi 23 persona, që iu bindën thirrjes së opozitës për mosbindje civile.

Për protestën në rrugën e Bradashesh policia procedoi 12 organizatorë dhe pjesëmarrës.

Për protestën në kryqëzimin e Çermës u proceduan penalisht 7 drejtues dhe anëtarë të opozitës.

Policia procedoi penalisht 4 persona për "Ndotje të ajrit", sepse gjatë protestave dogjën disa goma në rrugë, madje tha se po punon të

identifikojë edhe persona të tjerë në këto tubime.

Por, lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, e cilësoi një veprim qesharak të dyshes Arta Marku-Edi Rama vendimin për nisjen e procedimit penal ndaj deputetëve të opozitës për mosbindjen civile me bllokimin e disa rrugëve. "Është një veprim qesharak i hetuesisë politike Rama-Marku, i cili ekspozon, për fat të keq, atë që kemi paralajmëruar prej kohësh dhe tani Edi Rama ka futur në dorë edhe drejtësinë", tha Basha.

Duke folur për mediat pas një takimi të zhvilluar në selinë blu me kreun e Komunës së Mitrovicës, Basha bëri thirrje të hiqen pengesat ekzistuese dhe të lehtësohet komunikimi, si dhe të ulen kostot e të mos ekzistojë asnjë tarifë për Rrugën e Kombit.

LAJME SHKURT

Fleckenstein: T'i nisim negociatat me Shqipërinë

TIRANË, 8 PRILL - Eurodeputeti dhe Raportuesi për Shqipërinë, Knut Fleckenstein, duke iu referuar vizitës në Shqipëri, thekson se është bërë progres dhe se shqiptarët meritojnë të gjitha përpjekjet tona për ta sjellë Shqipërinë më pranë BE-së. "Javën e kaluar kam vizituar përsëri Shqipërinë. Përfundimi im është i qartë. Ne duhet t'i fillojmë negociatat me këtë vend. Progresi është bërë, ndonëse mbetet shumë punë. Pa dyshim. U inkurajua vërtet nga të rinjtë që takova në Tiranë, në Shkollën dhe në Qendrën Sociale në Bregu Lumit, ose në Universitetin e Durrësit. Ata të gjithë meritojnë të gjitha përpjekjet tona për ta sjellë Shqipërinë më pranë BE-së", u shpreh Fleckenstein. Knut Fleckenstein tha se "mund të kemi mendime të ndryshme për shumë vendime politike, por për këta të rinj në Tiranë vlen të punohet. Dhe unë jam i sigurt, studentët e Durrësit do të na ndihmojnë".



Vasili: Prokuroria është kthyer në zyrë të Qeverisë

TIRANË, 8 PRILL - Kryetari i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili, ka akuzuar të dielën prokurorinë për hetime të orientuara politikisht nga Qeveria. Në një reagim në rrjetet sociale, Vasili thotë se organi i akuzës ka dalë kundër

popullit. Sipas tij, Prokuroria është kthyer në zyrë të Qeverisë së drogës. Petrit Vasili ka kërkuar publikisht nga opozita dhe protestuesit që javën e ardhshme të mos lejojnë kryeministrin të hyjë në zyrën e tij. Kjo deklaratë ka krijuar panik në kryeministri, çka ka sjellë që Petrit Vasili të mbahet nën përgjim nga strukturat e kryeministrit. Kreu i deputetëve të LSI-së përgjohet pa vendim gjykatë dhe ky është një skandal qeveritar. Pjesë e skenarit të opozitës mbetet edhe bllokimi i hyrjes së ministrave në zyrat e tyre. Por Petrit Vasili ka kërkuar që protestuesit të vendosin edhe një tra, si në Rrugën e Kombit, para hyrjes së rrugës të shtëpia e kryeministrit në Surrë. Kjo gjë mund të sjellë përplasje të dhunshme mes policisë, gardës dhe protestuesve. Kreu i deputetëve të LSI-së ka deklaruar në shtabin e frontit opozitar se do të jetë ai i pari që do t'u prijë protestuesve dhe që do të vendosë traun para shtëpisë së Edi Ramës.



Gjuriq: Do të mbijetojmë dhe do të qëndrojmë në Kosovë

PRISHTINË, 8 PRILL - Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, tha të shtunën në mbrëmje që Serbia do të dijë ta mbrojë popullin e saj në Kosovë. Gjuriq i cili mori pjesë në liturgjinë e pashkëve ortodokse në Manastirin Banjska afër Zveçanit, tha se serbët do të mbijetojnë dhe të qëndrojnë në

Kosovë, kanë njoftuar mediet serbe. "Serbia do të jetë gjithmonë me popullin e saj në Kosovë. Ne serbët jemi popull numerikisht i vogël, por popull trim dhe liridashës dhe do të mbijetojmë dhe do të qëndrojmë në Kosovë", tha Gjuriq. Ai deklaroi se Serbia do të dijë ta mbrojë popullin e saj në Kosovë pasi, sipas tij,

që një mijë vjet këtu ndërtohet identiteti i popullit serb. "Do të dimë si Serbi që ta mbrojë popullin tonë në Kosovë. Sepse këtu në Kosovë që më shumë se 1 000 vjet ndërtohet identiteti i popullit serb, i tërë popullit serb. U ndërta në të kaluarën, ndërtohet edhe sot, të jeni të sigurt që do të ndërtohet edhe në të ardhmen",

tha Gjuriq.

Ai pati edhe porosi për Pashkët. "Për këto Pashkë porosis për këmbëgjulje, qëndrueshmëri dhe dashuri për të gjithë", tha Gjuriq, i cili erdhi dje në Kosovë me leje të institucioneve të Kosovës. Para gati dy



javësh, më 26 mars, ai u arrestua në Mitrovicën Veriore për hyrje ilegale në territorin e Kosovës.

AKR-ja këtë javë do të dalë me emrin e ministrit të Punëve të Brendshme

Sekretari i përgjithshëm i Aleancës Kosova e Re (AKR), Vesel Makolli, shpreson se këtë javë do të emërohet ministri i Punëve të Brendshme. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se aktualisht nuk ka ndonjë emër konkret për këtë pozitë por, sipas Makollit, strukturat e partisë janë duke u angazhuar për ta përzgjedhur njeriun e duhur. Pavarësisht prej zhvillimeve të fundit politike në vend, ai ka theksuar se AKR-ja nuk është për prishje të koalicionit qeverisës

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 8 PRILL - Sekretari i përgjithshëm i Aleancës Kosova e Re (AKR), Vesel Makolli, shpreson se ministri i Punëve të Brendshme do të emërohet gjatë kësaj jave. Ai ka bërë me dije të dielën për gazetën "Epoka e re", se aktualisht strukturat e partisë janë duke u angazhuar për përzgjedhjen e njeriut të duhur për këtë pozitë. "Besoj se strukturat e Aleancës Kosova e Re do të mblidhen gjatë kësaj jave për të diskutuar për zëvendësimin e ministrit të Punëve të Brendshme, në mënyrë që shumë shpejt ta kemi ministrin e ri të Punëve të Brendshme. Shpresoj se kjo çështje do të vendoset brenda kësaj jave. Jemi parti liberale dhe demokratike, prandaj kurrë nuk kemi menduar që për pozita shtetërore të propozojmë vetëm anëtar të AKR-së, por gjithmonë kemi luftuar t'i propozojmë njerëzit e duhur", ka deklaruar Makolli.

Ai ka treguar se aktualisht nuk ka ndonjë emër konkret për postin e ministrit të Punëve të Brendshme duke hedhur poshtë kështu edhe emrat që janë apostrofuat për postin e ministrit të Punëve të Brendshëm. "Ende në AKR nuk kemi emër konkret për këtë pozitë. Sa e di, askush nuk ka biseduar me atë (Florian Qehaja), emri i të cilit është

lakuar nëpër medie. Edhe presidenti Behgjet Pacolli ka bërë me dije se nuk ka biseduar me të. Por këtë çështje ne do ta shqyrtojmë në organet e partisë, sepse këto organe do të vendosin se kush do të jetë ministër i Punëve të Brendshme. Ne mendojmë, punojmë dhe veprojmë në atë formë për t'i pasur njerëzit e duhur në pozitat e duhura shtetërore. Në këtë drejtim nuk e këqyrim vetëm interesin partiak, sepse për ne, mbi të gjitha, është interesi shtetëror. Prandaj edhe për postin e ministrit të Brendshëm do ta zgjedhim njeriun e duhur", është shprehur Makolli.

Pavarësisht prej zhvillimeve të fundit politike, ai ka deklaruar se Aleanca Kosova e Re nuk është për prishje të koalicionit qeverisës. Sipas Makollit, kjo parti ka për qëllim ta shtyjë përpara agjendën shtetërore. Ai ka thënë se AKR-ja ka flijuar ministrin për të mos e prishur koalicionin. "Aleanca Kosova e Re ishte ajo që ka formuar këtë qeveri, përndryshe vendi ka qenë në një vakum institucional dhe kishte rrezik të përsëritet kriza politike paraprake. Koha që kemi humbur në mungesë të qeverisë tash po na reflektohet në punën e institucioneve tona. Prandaj, kemi bërë çmos për të mos e shikuar interesin tonë personal e partiak, por atë shtetëror. E kemi flijuar interesin tonë atëherë kur



e kemi formuar qeverinë dhe tash e kemi 'flijuar' ministrin tonë për të mos e prishur koalicionin. Kështu që, për nga ana e AKR-së nuk prishet koalicioni. Ne jemi për t'i shtyrë përpara gjërat sepse jemi parti institucionale", ka theksuar Makolli, duke shtuar se Kosovës i duhet shumë punë për ta përmirësuar imazhin e vet në arenën ndërkombëtare. "Edhe ashtu në arenën ndërkombëtare imazhi i

Republikës së Kosovës ka rënë, prandaj të gjithë ne duhet të punojmë në mënyrë që imazhi i Kosovës të ngrihet. Në këtë drejtim kemi shumë punë për të bërë", ka deklaruar Makolli. Ndërkohë ish-ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, është shkarkuar nga detyra për shkak të deportimit të gjashtë shtetasve turq. Vendimi për shkarkimin e tij është marrë nga kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, i cili ka

pohuar se nuk ka qenë i informuar paraprakisht për deportimin e gjashtë mësimdhënësve të Kolegjit "Mehmet Akif". Sipas Haradinajt, deportimi i turqve është bërë në kundërshtim me vlerat dhe parimet demokratike të shtetit të Kosovës. Për rastin e deportimit të shtetasve turq është shkarkuar edhe drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Driton Gashi.

Kjo javë do të jetë e nxehtë në Kosovë

PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Instituti Hidrometeorologjik në Kosovë (IHMK) ka njoftuar se masat e ngrohta të ajrit me origjinë nga Afrika Veriore do të jenë të pranishme gjatë kësaj jave mbi vendin tonë. Sipas IHMK-së, këto masa të ngrohta do të favorizojnë kushte për një mot

relativisht stabil dhe me temperatura mbi 20 gradë celsius. "Një situatë stabile e motit do të vazhdojë deri ditën e premte, ku më tej do të ketë zhvillim të vranësirave të cilat pasdite vende-vende mund të sjellin riga shiu të karakterit lokal. Shtypja atmosferike do t'i mbajë vlerat e

normales. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 5-8 gradë celsius, ndërsa maksimale e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet 22-24 gradë celsius. Do të fryjë erë kryesisht nga juglindja dhe jugperëndimi me shpejtësi maksimale deri 5m/s", është thënë në njoftimin e IHMK-së.



Flet për "Epokën e re", Flamur Hyseni

Kushtetuta duhet të plot

Profesori universitar i së Drejtës, Flamur Hyseni, ka thënë se Kushtetuta e Kosovës ka nevojë të plotësohet me disa kapituj në të ardhmen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", me rastin e shënimit të dhjetëvjetorit të Kushtetutës, Hyseni ka thënë se aktit më të lartë juridik të vendit duhet t'i shtohet kapitulli që ka të bëjë me konstitucionalizimin e partive politike dhe kapitujt që ndërlidhen me integrimet euroatlantike. Po ashtu, Hyseni ka shprehur edhe nevojën e ndryshimit të mënyrës së zgjedhjes së presidentit. Sipas tij, shefi i shtetit duhet të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli. Hyseni ka pohuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 9 prill 2008, ka arritur të realizojë dy qëllime kryesore: konstituimin e institucioneve themelore shtetërore dhe fillimin e procesit të transformimit të shumë segmenteve shoqërore

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 8 PRILL - Profesori universitar i së Drejtës, Flamur Hyseni, ka shprehur nevojën e ndryshimit të Kushtetutës së Kosovës. Ai ka bërë me dije se Kushtetuta e Kosovës ka nevojë të plotësohet me disa kapituj në dhjetë vjetët e ardhshëm.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", me rastin e shënimit të dhjetëvjetorit të Kushtetutës, Hyseni ka treguar se duhet të ndryshohet edhe mënyra e zgjedhjes së presidentit. "Disa formula kushtetuese kanë qenë si kushtëzime për të ekzistuar shteti i Kosovës, sepse kjo Kushtetutë ka pasur rol dhe mision historik, bërjen funksional të shtetit me të gjitha institucionet kryesore shtetërore. Këto kushtëzime, me kalimin e kohës, e humbasin rëndësinë e tyre dhe ndodhë ndryshimi. Kjo Kushtetutë në dhjetë vjetët e ardhshëm ka nevojë të plotësohet me kapituj të rinj për konstitucionalizimin e partive politike, integrimet evropiane dhe anëtarësimin në NATO. Ndërsa duhet të ndryshohet sa i përket mënyrës së zgjedhjes së presidentit. Presidenti duhet të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli", ka thënë Hyseni. Ai ka deklaruar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008, ka arritur të realizojë dy qëllime kryesore: konstituimin e institucioneve themelore shtetërore dhe fillimin e procesit të transformimit të shumë segmenteve shoqërore.

Hyseni ka vlerësuar se Kushtetuta është sfiduar disa herë por, sipas tij, akti më i lartë juridik në vend është mbrojtur me sukses nga Gjykata Kushtetuese. "Në secilën demokraci ka përpjekje të

forcave politike për t'iu shmangur Kushtetutës dhe procedurave kushtetuese, me qëllim të realizimit të ideve dhe projekteve politike në mënyrë më të shpejtë dhe më të lehtë, por aty ku ekziston institucioni shtetëror për mbrojtje të kushtetutshmërisë, këto veprime janë të pamundura. Tentimet për shkelje kanë ekzistuar, por ato nuk janë realizuar deri më tani sepse Kushtetuta është mbrojtur nga 'gardiani', Gjykata Kushtetuese", është shprehur ai, duke shtuar se sfidë e vazhdueshme mbetet forcimi i zbatimit të plotë të dispozitave kushtetuese nga institucionet shtetërore në tërë territorin shtetëror.

Ndër të tjera, ai ka ftuar institucionet që çdo vit të mbajnë kampanja që kanë për qëllim sensibilizimin e qytetarëve me Kushtetutën. "Pak ka pasur kampanja të tilla sensibilizuese me qytetarët për të nxitur dhe kultivuar ndjenjat e 'patriotizmit kushtetues dhe ligjor'. Kjo është dashur të bëhet qoftë nga vetë shteti, sidomos nga shoqëria civile, e cila është orientuar vetëm në vënien në pah dhe theksimin e anëve negative të secilit proces socio-politik në shoqërinë tonë. Së paku, një herë në vit duhet të kemi fushata të tilla sensibilizuese dhe vetëdijesuese lidhur me rëndësinë e Kushtetutës dhe kultivimin e vlerave kushtetuese", ka thënë Hyseni.

"Epoka e re": Z. Hyseni, Kosova më 9 prill shënon dhjetëvjetorin e Kushtetutës, aktit më të lartë juridik të vendit. A mendoni se gjatë këtyre dhjetë vjetëve Kushtetuta është respektuar nga segmente institucionale dhe qytetarët dhe ku i keni parë ju shkeljet?

Hyseni: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e mirat-

uar më 9 prill 2008, ka arritur të realizojë dy qëllime kryesore: konstituimin e institucioneve themelore shtetërore dhe fillimin e procesit të transformimit të shumë segmenteve shoqërore duke materializuar vlerat themelore të demokracisë liberale. Natyrisht se përgjatë këtyre dhjetë vjetëve Kushtetuta është sfiduar disa herë, por që ka arritur të mbrohet nga 'gardiani' i Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese. Në secilën demokraci ka përpjekje të forcave politike për t'iu shmangur Kushtetutës dhe procedurave kushtetuese, me qëllim të realizimit të ideve dhe projekteve politike në mënyrë më të shpejtë dhe më të lehtë, por aty ku ekziston institucioni shtetëror për mbrojtje të kushtetutshmërisë, këto veprime janë të pamundura. Tentimet për shkelje kanë ekzistuar, por ato nuk janë realizuar deri më tani sepse Kushtetuta është mbrojtur nga Gjykata Kushtetuese. Sfidë e vazhdueshme mbetet forcimi i zbatimit të plotë të dispozitave kushtetuese nga institucionet shtetërore në tërë territorin e vendit.

"Epoka e re": Është një vlerësim i opinionit se ka shkelje të Kushtetutës, pikërisht nga institucionet më të thirrura për përfilljen e Kushtetutës qoftë nga Kuvendi, Qeveria, Presidenca dhe Gjykata Kushtetuese. Pra, e kam fjalën për këta dhjetë vjet të miratimit të saj?

Hyseni: Po, në opinion ashtu është krijuar përshtypja, si rezultat se, demokracia mundëson që çdokush të krijojë opinion, pastaj si pasojë ka shumë konfuzion. Por, realiteti është shumë më ndryshe. Për këta dhjetë vjet ka pasur disa tentime për t'iu shmangur



rrugës kushtetuese për realizim të ideve dhe projekteve politike, siç ndodhë edhe në demokracitë më të avancuara, por këto shmangieje apo, siç njihen tani si 'shkelje kushtetuese', janë parandaluar dhe ndaluar nga Gjykata

Kushtetuese. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është shumë e pasur. Është rasti i dy presidentëve, janë shumë ligje që u është bërë verifikimi i kushtetutshmërisë, ka shumë kërkesa individuale të qytetarëve që janë trajtuar.

Ësohet me disa kapituj



dentit, i cili duhet të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli.

"Epoka e re": Profesor, rasti i transformimit të FSK-së në ushtri rezulton si një vakum dhe një defekt i kësaj Kushtetute, për arsye se pa ndryshimin dhe plotësimin e saj nuk mund të ketë avancim të statusit për transformim të FSK-së, pasi duhen 2/3 e paki-cave dhe 2/3 e shumicës shqiptare?

Hyseni: Formula e ndryshimit të Kushtetutës është e tillë, ku kërkohen votat e dyfishta 2/3. Por, kjo nuk paraqet ndonjë problem esencial sa i përket ndryshimit të statusit të FSK-së, sepse ndryshimi përmbajtjesor i statusit mund të bëhet edhe me ligj. Tjetër është projekti i ndryshimit të emërimit. Natyrisht se duhet për ta ndryshuar dispozitën përkatëse, sepse aktualisht emërimi është FSK dhe mund ta bëjmë: FAK, FARK, UK, URK etj. Por, mund të jetë edhe me emërimin si FSRK - Forca e Sigurisë e Republikës së Kosovës. Ndryshimet në Kushtetutë sa i përket emërimit nuk e nënkuptojnë edhe ndryshimin përmbajtjesor dhe të misionit substancial të Forcës së Sigurisë apo ushtrisë së Kosovës.

"Epoka e re": A mendoni se për t'u njohur sa më shumë qytetarët me aktin më të lartë juridik të vendit do të duhej të mba-heshin sa më shumë takime vetëdijësuese se si do të duhej të respektohej Kushtetuta?

Hyseni: Po. Kjo ka shumë rëndësi. Pak ka pasur kampanja të tilla sensibilizuese me qytetarët për të nxitur dhe kultivuar ndjenjat e 'patriotizmit kushtetues dhe ligjor'. Kjo është dashur të bëhet qoftë nga vetë shteti, sidomos nga shoqëria civile, e cila është orientuar vetëm në vënien në pah dhe theksimin e anëve negative të secilit proces socio-politik në shoqërinë tonë. Së paku, një herë në vit duhet të kemi fushata të tilla sensibilizuese dhe vetëdijësuese lidhur me rëndësinë e Kushtetutës dhe kultivimin e vlerave kushtetuese. Deri më tani, maksimumi që është bërë, ka qenë gëzimi për ditë pushimi, më 9 prill të secilit prej këtyre dhjetë vjetëve. Kushtetuta u nevojitet të gjithëve. Pozitës, më së shumti opozitës, medieve dhe shoqërisë civile, qytetarëve dhe studentëve, prandaj duhet të ekzistojë debati i hapur në mënyrë të përhershme për dhe lidhur me Kushtetutën.

"Epoka e re": Kjo Kushtetutë është paraqitur në disa raste si barrierë ose si pengesë e problemeve dhe zgjidhjeve të tyre. Ka pasur mendime të ndryshme sa i përket asaj nëse është e nevojshme të ndryshohet Kushtetuta. Cili

është opinionimi juaj?

Hyseni: Secila Kushtetutë ka nevojë që me kalimin e kohës të plotësohet, por edhe të ndryshohet. Disa formula kushtetuese kanë qenë si kushtëzime për të ekzistuar shteti i Kosovës, sepse kjo

Kushtetutë ka pasur rol dhe mision historik, bërjen funksional të shtetit me të gjitha institucionet kryesore shtetërore. Këto kushtëzime, me kalimin e kohës, e humbasin rëndësinë e tyre dhe ndodhë ndryshimi. Kjo

Kushtetutë në dhjetë vjetët e ardhshëm ka nevojë të plotësohet me kapituj të ri për konstitucionalizimin e partive politike, integrimet evropiane dhe anëtarësimin në NATO. Ndërsa duhet të ndryshohet sa i përket mënyrës së zgjedhjes së presi-

Ish-kryeministri Mustafa kthehet në Kosovë

PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, njëherësh kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), është kthyer nga Gjermania pas rreth tre

muajsh qëndrimi atje për shkaqe shëndetësore. Lajmin e ka bërë me dije përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Bajram Gecaj, ish-ministër i Qeverisë së

Kosovës në mandatin e kaluar.

Në fillim të këtij viti, ish-kryeministri Mustafa, për shkak të problemeve shëndetësore, ishte shtrirë në

një spital privat në Prishtinë. Më 15 janar të këtij viti ai kishte udhëtuar për në Gjermani për t'iu nënshtruar disa ekzaminimeve për një diagnozë të saktë.



Liderët urojnë besimtarët ortodoksë për Pashkët

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj, të gjithë besimtarëve ortodoksë ua kanë uruar të dielën Pashkët. Me këtë rast ata kanë vlerësuar se kjo festë të shërbejë për ta rritur unitetin dhe tolerancën ndërmjet njerëzve

Prishtinë, 8 prill (ER) - Liderët institucionalë i kanë uruar të gjithë besimtarët ortodoksë për Pashkët. Përmes rrjeteve sociale ata kanë uruar qytetarët që kjo festë e ringjalljes t'i frymëzojë për të qenë çdoherë në anën e të mirës dhe të së drejtës. "Të gjithë besimtarëve ortodoksë u shpreh urimet më të përzemërta për festën e Pashkëve. Festat fetare gjithmonë kanë shfaqur ndjenjat e mirësisë, besimin në vlera pozitive religjioze, dashurinë dhe respektin e ndërsjellë mes qytetarëve tanë, pa dallim etnik. Festa e Pashkëve le të kremtohet në familjet e besimtarëve me dinjitet, me lutje për lumturi, paqe dhe harmoni njerëzore", ka shkruar presi-

denti Hashim Thaçi në profilin e vet në "Facebook". Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ua ka uruar besimtarëve ortodoksë Pashkët. Veseli në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se në këtë festë, kujtojmë mesazhin human që bartë me vete ringjallja, për fitoren e shpresës dhe mirësisë. "Të gjithë besimtarëve ortodoksë të vendit tonë ua uroj Pashkët, me dëshirat më të mira për paqe, shëndet e begati. Në këtë festë kujtojmë mesazhin human që bartë me vete ringjallja, për fitoren e shpresës dhe mirësisë. Le të jetë festa edhe moment frymëzimi për dashuri, mirëkuptim dhe përparim në vendin tonë, për të



gjithë pa dallim", ka shkruar Veseli.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka uruar që kjo festë të shërbejë për ta rritur unitetin dhe tolerancën ndërmjet njerëzve. "Shqiptarëve dhe

të gjithë bashkëqytetarëve të tjerë ortodoksë të Kosovës, si dhe pjesëtarëve të institucioneve ndërkombëtare të këtij besimi që punojnë në vendin tonë, për shumë mot Pashkët. Kjo festë e ringjalljes na frymëzon

për të qenë kurdoherë në anën e të mirës, të së drejtës dhe na ofron mundësinë për ta rritur unitetin dhe tolerancën ndërmjet njerëzve", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Veseli, në odën e familjes Demaku në Abri, ndan kujtime për luftën e UÇK-së



PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka qëndruar të shtunën mbrëma në familjen Demaku në Abri, në përvjetorin e rënies së heroit të UÇK-së, Xhevat Demaku. Veseli nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se me bacën Haxhi kanë ndarë së bashku kujtimet për

ditët e rënda të pranverës së vitit 1999. "Isha për vizitë në familjen Demaku në Abri, në përvjetorin e rënies së heroit të UÇK-së, Xhevat Demaku. Me bacën Haxhi ndamë së bashku kujtimet për ditët e rënda të pranverës së vitit 1999, kur e gjithë Kosova, mes jetës e vdekjes, po luftonte për liri. Ato ditë të gjithë djemtë e bacës Haxhi ishin në frontet e betejave. Në luftimet e 7 prillit

bie dëshmor Xhevat Demaku, bashkë me Bedri Demakun dhe Imer Shalën. Dhimbja ishte e madhe për bacën Haxhi e për nënën Qamile, por edhe më e madhe forca shpirtërore për t'u dhënë vullnet djemve të tjerë e shokëve të tyre për ta vazhduar luftën e lavdishme të UÇK-së deri në çlirim. Falë kësaj force shpirtërore ne ia dolëm", ka shkruar Veseli.

Tahiri: Reformat gjithëpërfshirëse janë të domosdoshme

PRISHTINË, 8 PRILL (ER) - Koordinatorin Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka thënë se në dekadën e dytë të shtetësisë është e domosdoshme të hedhen themelet të forta shtetërore përmes reformave substanciale. Ai ka deklaruar se këto reforma duhet të jenë gjithëpërfshirëse. "Themelet

që duhen ngritur me reformat ose do të shërbejnë për ta ngritur shtetin ose ne lejojmë që mekanizmat institucionalë të kthehen në pengesa të patejkalueshme të zhvillimit. Andaj, një proces i qartë, gjithëpërfshirës dhe me përfshirjen e ekspertizës vendore dhe ndërkombëtare, duhet të jenë shtylla të zba-

timit të proceseve reformuese", ka deklaruar të dielën Tahiri. Ai ka thënë se procesi i reformave i bashkon të gjithë. "Jemi me fat që ky qëllim nuk ndanë pozitë dhe opozitë, pasi të gjithë aktorët si në Kuvend ashtu edhe në sektorin e tretë e synojnë këtë cak", ka theksuar Tahiri.



Tahiri: Serbisë nuk i intereson Asociacioni, por ndryshimi i kufijve

"Faza e tretë e dialogut duhet të fillojë dhe të përfundojë me njohjen reciproke mes dy shteteve, si një zgjidhje e qëndrueshme që hap mundësinë që, më në fund, të ketë marrëdhënie fqinjësore dhe paqësore ndërmjet dy shteteve", ka thënë ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri

PRISHTINË, 8 PRILL - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se fillimi i fazës së re të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që po zhvillohet në Bruksel me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, duhet të përfundojë me njohje reciproke, ndërsa Serbia t'i zbatojë marrëveshjet e arritura deri më tani. "Është me rëndësi që dialogu po kalon në fazën e fundit, fazën përfundimtare dhe të dy proceset duhet të shkojnë paralelisht. E para, që të bëhet zbatim i marrëveshjeve të mbetura ku përgjegjësia kryesore për moszbatimin i takon palës serbe, duke qenë se Kosova vazhdimisht i ka përmbushur obligimet dhe tashmë ajo ka filluar edhe zbatimin e marrëveshjes për Asociacionin. Ndërsa në fazën e dytë, Serbia ka bllokuar një varg marrëveshjesh siç janë energjia, çështja e diplomave, kadastrave, pengimi i vendosjes së institucioneve shtetërore në veri ku janë punësuar ish-pjesëtarët e strukturës që është shuar 'Mbrotjtja Civile', pastaj është bllokuar ura që të hapet e të

tjera. Faza e tretë e dialogut duhet të fillojë dhe të përfundojë me njohjen reciproke mes dy shteteve, si një zgjidhje e qëndrueshme që hap mundësinë që, më në fund, të ketë marrëdhënie fqinjësore dhe paqësore ndërmjet dy shteteve dhe të kemi një paqe më të mirë në rajon", ka thënë Tahiri në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Ajo ka theksuar se duke marrë parasysh se të dyja shtetet aspirojnë për t'u bërë anëtare të Bashkimit Evropian, ndërkohë Kosova synon edhe anëtarësimin në NATO dhe OKB, është në interes për të dyja shtetet që t'i mbyllin çështjet e hapura të së kaluarës. "Njohja reciproke mes të dy shteteve është rezultat jo vetëm i zhvillimeve historike të zhbërjes së ish-Jugosllavisë, ku Kosova ka qenë një prej njësive federale, por pavarësia e Kosovës është në pajtim edhe më të Drejtën Ndërkombëtare duke marrë parasysh se Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi ka konfirmuar ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës, si dhe është një realitet i ri i krijuar me shtatë



shtetet e reja në Ballkan pas shuarjes së ish-shtetit jugosllav", ka thënë Tahiri. Duke folur rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe,

Tahiri ka thënë se marrëveshja për Asociacionin e arritur në Bruksel ka për bazë ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Pra, kjo marrëveshje e Brukselit nuk i jep

kompetenca ekzekutive Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë", ka thënë ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri.

Në morgun e Prishtinës janë 300 mbetje mortore

PRISHTINË, 8 PRILL - Në Institutin e Mjekësisë Ligjore (ILM) janë mbi 300 mbetje mortore të cilat datojnë nga Lufta e Parë Botërore e deri në luftën e vitit 1999 në Kosovë, e që nuk janë identifikuar ende se kujt i përkasin. Shumica e këtyre mbetjeve mortore janë të personave që nuk ndërliken me luftën e fundit, por që aktualisht janë në morgun e Prishtinës. Në morg ka trupa të foshnjave të porsalindura, por edhe shtetas të huaj të cilët kanë vdekur në mënyra të ndryshme që nga paslufta, por që asnjëherë askush nuk i ka kërkuar. Këta të fundit do të varrosen në një lokacion që Komuna e Prishtinës ka ndarë afër varrezave në Dragodan. Por, në këto varreza nuk do të varrosen mbetjet mortore që kanë mbetur nga lufta e fundit. Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, Arsim Gërxhaliu, ka bërë me dije për "Kosovapress" se për shkak të mbingarkesës të frigoriferëve me

mbetje mortore, ato do të varrosen për të liru hapësira në frigoriferë në mënyrë që të krijohet hapësirë për prurjet e reja. Ai ka theksuar se janë përkujdesur që varrimi i tyre të bëhet me kujdes të veçantë, në mënyrë që nëse del diçka e re pas analizave të ADN-së, këto mbetje të mund të zhvarrosen dhe t'u jepen familjarëve. Gërxhaliu ka thënë se mbetjet mortore të luftës së fundit do t'i mbajnë sepse ato kanë mbetur çështje e hapur dhe se së shpejti do të dalë një strategji nga Qeveria lidhur me qasjen ndaj tyre. Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Ligjore ka theksuar se problem në vete për mosidentifikimin e deritashëm të këtyre mbetjeve ka qenë mënyra e punës e Tribunalit të Hagës. Ndërsa këshilltari i kryeministrit Ramush Haradinaj, Jahja Lluka, i cili është bartës i dosjes për persona të zhdukur në Qeverinë e Kosovës, ka thënë se morgu i Prishtinës është i mbingarkuar me mbetje mortore.



"Ne së bashku me Institutin e Mjekësisë Ligjore kemi ardhur deri te një përfundim, se është mirë që të gjithë ata njerëz ta kenë një varr. Aty në morgun e Prishtinës ka njerëz të cilët kanë prejardhje të

ndryshme nga shumë shtete, por edhe nga shumë qytete të Kosovës. Kemi raste kur familjarët nuk duan t'i marrin mbetjet mortore të familjarëve të vet për arsye se kanë qenë bashkëpunëtorë të okupa-

torit", ka thënë Lluka. Në Kosovë aktualisht janë 1 652 persona që figurojnë të zhdukur në luftën e vitit 1999 dhe iu përkasin të gjitha përkatësive etnike.

Reçica: Të rinjtë të bëhen pjesë e tregut të punës përmes QAP-it



Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, u ka bërë thirrje të gjithë të rinjve, kandidatëve potencialë dhe të papunëve, të regjistrohen pranë zyrave të punësimit në komunat e Kosovës dhe të paraqiten pranë Qendrave të Aftësisë Profesionale (QAP), si një mundësi e jashtëzakonshme për t'u aftësuar në profile të ndryshme dhe të bëhen pjesë e tregut të punës.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 PRILL - Përgjatë dy javëve rresht ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, me qëllim të promovimit të aftësisë dhe riaftësisë profesionale, ka vizituar shtatë Qendrat e Aftësisë Profesionale (QAP) në Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj,

Prizren, Gjakovë dhe Pejë. Gjatë vizitave në këto qendra aftësuese, ministri Reçica ka takuar shumë kandidatë, të rinj dhe të reja, madje disa me studime universitare dhe pasuniversitare të përfunduara, të cilët kanë ndjekur dhe po ndjekin kurse të aftësisë në profesione të ndryshme. Gjithashtu, Reçica ka takuar edhe shumë të certifikuar që

kishin kryer aftësim në fusha si rrobaqepësi, zdrukthuari, floktari, dizajn grafik, të cilët falë kurseve të aftësisë që kishin ndjekur paraprakisht në QAP-a, kanë arritur të gjejnë punë apo të hapin bizneset e tyre. Nga përfaqësuesit e qendrave, ministri u njoftua se shumica e të certifikuarve arrijnë të bëhen pjesë e tregut të punës, madje edhe të punësojnë të tjerë në

bizneset që ata hapin. Ministri në fund të vizitave ka thënë se ajo çfarë ka arritur të shohë këto ditë është përkushtimi i personelit trajnues të qendrave për t'i aftësuar kandidatët e interesuar, si dhe vullneti i shumë të rinjve dhe të rejave për të ndjekur kurse aftësimi pranë qendrave përkatëse. "Kemi zhvilluar një javë të promovimit të aftësisë profesionale duke vizituar shtatë qendrat e aftësisë profesionale në komunat e Republikës së Kosovës. Pata fatin të takoj të rinj dhe të reja, me aftësi dhe me kualifikime universitare dhe pasuniversitare, të etur për të zënë dije dhe njohuri. Gjithashtu, takova të rinj dhe të reja të cilët, pas trajnimeve që kanë bërë në këto qendra të aftësisë profesionale, kanë treguar suksese, duke hapur bizneset e tyre, madje edhe duke punësuar të tjerë në këto biznese", është shprehur Reçica.

Ministri u ka bërë thirrje të gjithë të rinjve, kandidatëve potencialë dhe të papunëve, që të regjistrohen pranë zyrave të punësimit në komunat e Kosovës dhe të paraqiten pranë Qendrave të Aftësisë Profesionale, si një mundësi e jashtëzakonshme për t'u aftësuar në profile të ndryshme dhe të bëhen pjesë e tregut të punës.


Në shtatë qendrat e aftësisë profesionale janë gjithsej 60 punëtori dhe 30 profile të certifikuar. Në periudhën shtator 2017-mars 2018, në shtatë Qendrat e Aftësisë Profesionale (QAP) kanë ndjekur trajnime gjithsej 3 519 kandidatë, ndërkaq janë certifikuar 2 432 prej tyre.

Përgjatë së njëjtës periudhë në të gjitha Zyrat e Punësimit në nivel vendi janë regjistruar 10 433 punëkërkuar të rinj. Në punësim të rregullt janë përfshirë 2 346 persona, ndërkaq në masat aktive të tregut të punës janë përfshirë 1 466 persona.

Shtohen mostrat e mishit që shkojnë për analiza

PRISHTINË, 8 PRILL - Sipas drejtoreshës së Qendrës së Laboratorëve Testues, Drita Zogaj, kohët e fundit janë shtuar mostrat e mishit që shkojnë për analiza në këta laboratorë. Zogaj ka thënë për "Kallxo.com" se nga viti 2012 ka pasur rënie të dërgimit të mostrave në këtë qendër, por në tre muajt e fundit këto mostra janë shtuar. Zogaj ka treguar se në tre muajt e fundit në Qendrën e Laboratorëve Testues që funksionon në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike janë dërguar 113 mostra ushqimesh, 38 prej tyre nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ajo ka bërë me dije se në Qendrën e

Laboratorëve në këtë kohë kanë ardhur më shumë mostra të mishit. "21 mostra ushqimore të AUV-it janë produkte të mishit", ka thënë Zogaj. Në mars shpërtheu skandali i mishit nga Belgjika kur në këtë shtet një kompani që kishte importuar mish edhe në Kosovë u mbyll për shkak të kushteve jo higjienike të mbajtjes së mishit. Njërit prej importuesve të këtij mishit në Kosovë i është caktuar paraburgimi prej 30 ditësh. E pyetur se çfarë kërkohet më së shpeshti nga analiza e mostrave të mishit, drejtoresha Zogaj ka thënë se më shumti kërkohet që të vërtetohet nëse ky mish është i freskët.



Ministria e Financave, reforma të mëdha në tatime

Ministria e Financave ka njoftuar se nga kjo javë do të lirohen nga tatimi doganor dhe akciza pajisjet e teknologjisë informative për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke përfshirë edhe pjesët rezervë për pajisjet e prodhimit

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 PRILL - Me qëllim të zbatimit të reformave fiskale, ministri i Financave, Bedri Hamza, përveçse ka sjellë në fuqi vendimet për lirim nga tatimi doganor dhe akciza për lëndën e parë, gjysmëproduktet, linjat e prodhimit, gjithashtu nga kjo javë do të lirohen pajisjet e teknologjisë informative për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe pjesët rezervë për pajisjet e prodhimit, si dhe është duke e rishqyrtuar edhe legjislacionin e tatimit në të ardhura personale, të ardhura të korporatës, Ligjin e TVSh-së dhe Ligjin e Administratës dhe Procedurës Tatimore. "Përmes rishikimit të legjislacionit, Ministria e Financave do ta ndihmojë zhvillimin e sektorit privat, në këtë rast sektorin e prodhimit që të ketë mundësi më të mëdha

të zhvillimit të prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve jo vetëm brenda vendit tonë, por edhe jashtë", është thënë në komunikatën e MF-së.

Ministria e Financave ka theksuar se rezultat shumë pozitiv është arritur përmes vendimeve për lirim nga tatimi doganor dhe akcizës. "Tani do të vazhdojmë reformën ligjore më të madhe në vendin tonë me Ligjin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar ku, përveç lirimit të lëndës së parë, e cila prodhohet në vendin tonë, nga tatimi i vlerës së shtuar do të bartet mbledhja e tatimit të vlerës së shtuar nga kufiri në brendësi të vendit, kjo reformë do të jetë një ndihmë shumë e madhe për biznesin për arsye se në të ardhmen bizneset nuk do të kenë të obligueshme të paguajnë paraprakisht tatimin e vlerës së shtuar në kufi me rastin e importimit pa e shitur mallin, por do ta paguajnë në brendësi të vendit pas periudhës



së rregullt ligjore", është bërë me dije në komunikatën e Ministrisë së Financave. Sipas MF-së, kjo reformë mundëson që bizneset të kenë likuiditet më të madh. "Biznesi do ta ketë mundësinë të investojë më shumë në zgjerimin e biznesit dhe do të kursehet nga kreditë dhe interesat e ndryshme bankare që kanë qenë të obliguar t'i marrin për ta paguar tatimin e

vlerës së shtuar në kufi. Kosova prinë për këtë reformë të madhe dhe të guximshme në rajon, por ministri i Financave është i përkushtuar për të bërë reforma që e ndihmojnë sektorin privat dhe që e luftojnë burokracinë dhe informalitetin me të vetmin qëllim që Kosova të jetë atraktive për investitorët e vendit dhe të huaj", është thënë në komunikatën e

kësaj ministrie.

Me këtë rast, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka ftuar të gjithë komunitetin e biznesit dhe gjithë bizneset individuale të vazhdojnë ta ndihmojnë ministrinë me kërkesa dhe këshilla në mënyrë që t'i ndihmojnë ata për kalimin e sfidave me të cilat përballet biznesi gjatë punës së përditshme në të bërit biznes.

Shqipëria ua heq vizat shtetasve kinezë, pritet të rritet numri i turistëve

Sipas të dhënave të operatorëve turistikë, deri më tani vizitat e shtetasve kinezë në Shqipëri kanë qenë më shumë rastësore, jo destinacion i drejtpërdrejtë. Pjesa më e madhe e kinezëve i janë drejtuar Shqipërisë nga vendet fqinje, Maqedonia, Mali i Zi apo Greqia

TIRANË, 8 PRILL - Qeveria e Shqipërisë ka njoftuar për heqjen e vizave për shtetasit kinezë për periudhën 1 prill deri më 31 tetor 2018. Vendimi është mirëpritur veçanërisht nga ambasadorja kineze në Shqipëri, Jiang Yue, e cila ka thënë kjo do të sjellë progres në shkëmbimet ndërmjet dy vendeve.

Për qeverinë shqiptare, por edhe për ambasadorin kinez, heqja e vizave do ta shtojë numrin e turistëve në Shqipëri, të cilët tanimë kanë një arsye më shumë për t'ju drejtuar Shqipërisë drejtpërdrejt nga Kina. Sipas të dhënave të operatorëve turistikë, deri më tani



vizitat e shtetasve kinezë në Shqipëri kanë qenë më shumë rastësore, jo destinacioni i drejtpërdrejtë.

Pjesa më e madhe e kinezëve i janë drejtuar Shqipërisë nga vendet fqinje, Maqedonia, Mali i Zi apo Greqia, ku kanë zgjedhur për t'i

kaluar pushimet në bregdetin shqiptar. Sipas ambasadores kineze, Shqipëria ka shumë vende të bukura turistike, por kinezët kanë më shumë interes t'i shohin Krujën dhe Gjirokastrën. Sipas të dhënave nga Ambasada e Kinës në Shqipëri, Italinë vitin e kaluar e

kanë vizituar tre milionë turistë kinezë, ndërsa Greqinë rreth një milion turistë.

Në raportin e fundit të Instatit në shkurt të këtij viti, mbi lëvizjet e shtetasve në Shqipëri nuk gjen të dhëna mbi shtetasit kinezë që vijnë në Shqipëri, kjo edhe për

shkak të kufizimit për shkak të vizave.

Zyrtarisht, Kina është burimi i parë në botë për turistë jashtë kufijve, vetëm në vitin 2017 ishin 130 milionë turistë në botë dhe konsumi i tyre kap vlerën e 110 miliardë dollarëve.

Në kuadër të "Ditëve të Kuvendit" deputetët bashkëbiseduan me qytetarë të Gjilanit

Kurteshi: Komunikimi me qytetarë duhet t'u imponohet institucioneve lokale

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë se komunikimi me qytetarë duhet t'u imponohet institucioneve lokale dhe atyre qendrore, sidomos për çështjet me interes të madh publik



EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

GJILAN, 8 PRILL - Qyteti i Gjilanit ishte nikoqiri i parë i një grupi të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët, në kuadër të aktivitetit "Ditët e Kuvendit" dhe në funksion të komunikimit të drejtpërdrejtë, kanë filluar takimet me qytetarë. Gjatë këtij aktiviteti ishin të pranishëm deputetët: Zenun Pajaziti, Lirije Kajtazi, Ismajl Kurteshi, Besa Baftiu dhe Ahmet Isufi, të cilët kanë bashkëbiseduar me qytetarë gjilanas lidhur me zhvillimet aktuale politike në vend, për objektivat e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për çështje të tjera që preokupojnë qytetarët e këtij lokaliteti.

Takimin e ka moderuar përfaqësuesi i shoqërisë civile, Albert Krasniqi (KDI), i cili në hapje të tij bëri me dije se deputetët e ftuar në këtë takim vijnë nga rajoni i Gjilani dhe kanë marrë votën e qytetarëve të tij.

Deputeti i PDK-së, Zenun Pajaziti, njëherësh kryesues i Forumit për Transparencë Parlamentare, ka bërë një përshkrim të proceseve nëpër të cilat po kalon vendi ynë, ndërsa u ndal edhe në

objektivat e Kuvendit, duke e konsideruar atë vend ku merren vendimet më të rëndësishme për qytetarët.

Pajaziti ka prezantuar funksionin dhe aktivitetet e Forumit për Transparencë, i cili në përbërje të vet mbledh deputetë nga të gjitha grupet parlamentare dhe shoqëria civile. Ai ka thënë se në këtë mandat janë zgjeruar aktivitetet, duke përfshirë këtu edhe takimet me qytetarë. "Kuvendi i Kosovës vlerësohet institucioni më transparent", ka thënë Pajaziti.

Deputeti i AAK-së, Ahmet Isufi, është fokusuar në rolin e Komisionit për Integritet Evropian. Duke folur për liberalizimin e vizave, Isufi ka vlerësuar se shtetit të Kosovës i është bërë padrejtësi e madhe lidhur me kriteret e paraqitura dhe se Kosova nuk është fajtorë për vonesën. Ai ka thënë se qytetarët e Kosovës së shpejti do të kenë të drejtën e lëvizjes së lirë.

Deputetja e LDK-së, Lirije Kajtazi, e ka konsideruar këtë takim mundësi të mirë për të biseduar drejtpërdrejt me qytetarët. Ajo ka folur për punën që bën në kuadër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Në kuadër të kësaj, Kajtazi ka folur edhe për vizitën e komisionit në Institutin për Ushqim dhe Veterinari dhe shqetësimin e

ngritur lidhur me konsumimin e produkteve të prishura.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë se komunikimi me qytetarë duhet t'u imponohet institucioneve lokale dhe atyre qendrore, sidomos për çështjet me interes të madh publik, siç ishte rasti i deportimit të gjashtë shtetasve të Turqisë. Ai ka theksuar se transparenca nuk bëhet me lutje, por me presion.

Ndërkaq kryetarja e Komisionit për Shëndetësi, Besa Baftiu, ka shprehur shqetësimin se Kosova vazhdon të mbetet i vetmi shtet që nuk ka sigurime shëndetësore dhe se shëndetësia, sipas saj, nuk është parë asnjëherë si prioritet. Më tutje, ajo ka pohuar se fokus do ta ketë të mirën dhe mirëqenien e qytetarëve.

Në vazhdim, qytetarë të Gjilanit, duke shprehur vlerësime për vizitën e deputetëve të Kuvendit në qytetin e tyre dhe mundësinë për të bashkëbiseduar me ta, adresuan një varg pyetjesh dhe ngritën shqetësime të ndryshme, të cilat kishin të bënin me çështje dhe problematika nga niveli lokal, deri te proceset e rëndësishme politike të vendit. Ky aktivitet u zhvillua me iniciativë të Forumit për Transparencë Parlamentare dhe mbështetjen e NDI-së.

RAPORTI POLICOR



Rrah babanë shqelma e grushte

RAHOVEC, 8 PRILL - Policia e Kosovës ka njoftuar se një person është arrestuar në Rahovec pas zënkës që kishte pasur me babanë e vet. Personi në fjalë e kishte sulmuar fizikisht atë duke e goditur me shqelma dhe grushte. Si pasojë e sulmit, viktimja ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe është dërguar në tretman mjekësor. I dyshuari, me vendim të prokurorit, është dërguar në mbajtje.

Policia arreston dy persona që mashtronin qytetarët

PEJË, 8 PRILL - Policia në Pejë ka arrestuar dy persona të cilët, në Sheshin "Zahir Pajaziti", janë kapur në flagrancë, duke mashtruar qytetarët. Nga të dyshuarit janë konfiskuar disa raporte mjekësore, fotografi si dhe para. Me urdhër të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje.

Një person lëndohet rëndë në vendin e punës

GRAQANICË, 8 PRILL - Një person ka pësuar lëndime të rënda trupore në vendin e tij të punës në Graqanicë. Viktimja është dërguar në QKUK dhe, sipas mjekut, është jashtë rrezikut për jetë. Njësitë përkatëse të policisë janë duke hetuar rastin.

E rrah gruan, policia e arreston

PRISHTINË, 8 PRILL - Policia e Kosovës ka arrestuar një person i cili kishte ushtruar dhunë në familje. Sulmi raportohet të ketë ndodhur pas një mosmarrëveshjeje në mes të çiftit. Viktimja ka pranuar tretman mjekësor ndërkaj që dyshuari, me urdhër të prokurorit, është dërguar në mbajtje.

Policia shpërthen mjetin e dyshimtë te 'Ali Sokoli'

PRISHTINË, 8 PRILL - Policia e Kosovës të dielën ka bërë shpërthimin e bombës së dorës e cila është gjetur në afërsi të Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Ali Sokoli" në Prishtinë. Nuk dihet se kush e ka vendosur mjetin shpërthyes, por policia ka njoftuar se është duke e hetuar rastin.



Feja dhe integrimi i Kosovës në BE



Nga Mimoza KELMENDI

Feja islame është feja më e përhapur në Kosovë dhe e përqafuar nga pjesa më e madhe e popullatës shqiptare etnike, boshnjake, gorane dhe turke, si dhe nga disa anëtarë të bashkësisë rome, ashkali dhe egjiptiane. Në Kosovë e sidomos për popullsinë etnike shqiptare feja islame është përqafuar në kohën e sundimit osman në Ballkan dhe shumë karakteristika të saj përputhen me praktikën e kohës osmane. Ndërkohë vitet e fundit ka një lloj vëmendje të madhe ndaj rolit të fesë në rajon. Me anë të fuqisë financiare dhe influencës

kulturore disa vende myslimane si Turqia dhe Arabia Saudite po përqipen t'i ndryshojnë karakteristikat politike, kulturore dhe fetare në shoqëritë shqiptare në Ballkan, me qëllim krijimin e një terreni pjellor për islamin politik në rajon.

Madje pas zhvillimeve të fundit në mes të Prishtinës dhe Ankarasë u krijua një lloj paniku tek qytetarët jo vetëm për faktin e shkeljeve të drejtave të njeriut por, mbi të gjitha, të shtyrjes së liberalizimit të vizave nga BE apo të devijimit të rrugës së integrimit evropian të Kosovës. Shumë analistë e shohin rolin e presidentit turk Erdogan në marrëdhënie me homologun e tij në Kosovë si një "ekspansion" të Turqisë, i cili mund të rezultojë negativisht në proceset e ardhshme integruese të Kosovës në BE. Disa të tjerë mendojnë se "invazioni" i Turqisë në Kosovë do t'i largonte investimet gjer-

mane, austriake, italiane apo skandinave në këtë shtet të ri të Ballkanit.

Nëse do t'u referohemi rezultateve të një ankete të Gallup Europe, shqiptarët e Kosovës rezultojnë të jenë qytetarët më të lidhur me religjionin në Ballkan dhe Evropë. Ka qenë pikërisht pyetja "A ka ndikim feja në jetën tuaj të përditshme?", ku rreth 90 % e kosovarëve janë përgjigjur pozitivisht. Ndërsa nga një studim statistikor i zhvilluar nga Qendra e Studimeve Humanistike "Gani Bobi" dalin disa të dhëna interesante. Rreth 80.6 % e të anketuarve janë shprehur se janë pro kursit pro-perëndimor të Kosovës dhe se ai është i vetmi drejtim që duhet të ndjekë Kosova.

Feja është element i identitetit dhe vetëdijes të një populli dhe, si e tillë, është e patjetërsueshme dhe në planin evropian. Vetë feja katolike ka luajtur një rol thelbësor në formimin e

identitetit kulturor evropian, por edhe në formimin e identiteteve parashtetërore e shtetërore evropiane. Shumë prej parimeve humaniste evropiane janë edhe parime humaniste karakteristike të humanizmit katolik. Duke u nisur nga gjykime dashakeqe shpesh dëgjohet të thuhet se feja islame nuk është në përputhje me identitetin evropian, tradicionalisht të krishterë, dhe që një shtet islamik nuk mund të bëhet pjesë e komunitetit evropian.

Por ky është thjesht një paragjykim, sidomos po të aktualizohet me Kosovën. Madje diplomati austriak Wolfgang Petritsch mendon ndryshe: "Për popullatën shqiptare të Ballkanit feja kurrë nuk ka qenë një çështje vërtet e rëndësishme. Nuk e di nëse kjo sot ka ndryshuar, por nuk mund të krahasohet me myslimanët e Bosnjës ku, pas luftës, pati një kthim më të fortë tek

feja. Nuk e kam përshtypjen që feja në Kosovë apo Shqipëri luan një rol dominues".

Islamizmi i këtyre vendeve si Kosova do të ishte një vlerë e shtuar në "arkën" e vlerave evropiane. Gjithashtu nga pikëpamja numerike, numri i besimtarëve myslimanë në këto vende mund të krahasohet me numrin e emigrantëve që janë besimtarë myslimanë në njërin prej vendeve më të mëdha të BE-së, Gjermaninë. Po kështu vetë Bullgaria, anëtare e BE-së që nga viti 2005 ka një komunitet të gjerë mysliman në përbërje të shtetit dhe nuk ka pasur pengesa për shkaqe fetare në rrugën e saj drejt BE. Pra, domosdoshmëria e "së njëjtës fe" apo "papranueshmëria e islamizmit nën flamurin e BE" janë vetëm retorika dashakeqe që synojnë përçarje të vlerave të përbashkëta evropiane midis vendeve të Ballkanit, duke përfshirë edhe Kosovën dhe BE-në.

Të rinjtë, të rrezikuar nga drogat e reja në treg

PRISHTINË, 8 PRILL - Numri i përdoruesve të substancave narkotike është mjaft i madh dhe në rritje. Kështu kanë bërë me dije zyrtarë që merren me këtë çështje. Shqetësues mbetet fakti se në Kosovë në vazhdimësi hyjnë droga të reja që përdoren nga të rinjtë pa pasur njohuri për to.

Drejtuesi i Qendrës Mediko-Psikoterapeutike "Labirint", Safet Blakaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se droga më e re që ka hyrë në treg është ajo e quajtur 'DOC' (Chloro, 2.5 dimethoxyamphetamine), që është tip i halucinogjenëve. Ai ka theksuar se edhe droga 'GHB' (Hydroxybutyric acid) është një nga më problematike, e që po përdoret shumë nga të rinjtë prej vitesh. Sipas Blakajt, shqetësues mbetet fakti se fëmijët e moshës 12-vjeçare në Kosovë përdorin marijuanë.

Sipas statistikave që qendra "Labirinti" ka, rreth 20 për qind e nxënësve në shkollë përdorin substanca narkotike, derisa në gjithë Kosovën thuhet se janë rreth pesë mijë përdorues të drogave në mënyrë aktive, derisa 25 mijë përdorues që herë pas herë përdorin droga. "Sa i përket moshës mesatare të personave që përdorin droga, posaçërisht vitin e fundit ka rënë dukshëm, është 16 vjeç. Kjo është një rënie e



dukshme nëse krahasohet me vitet paraprake. Moshë ekstreme që është paraqitur, e që nuk kanë qenë (raste) të shumta, ka qenë moshë 12 vjeç. Droga më e përdorur është marijuana, derisa në Prishtinë paraqiten kohë pas kohe edhe droga të reja e që janë të tipave halucinogjenëve, që quhet DOC. Kjo përdoret në formë tablete. Moshat që e përdorin këtë drogë janë kryesisht 16

deri në 23 vjeç. Gjithashtu, GHB, një tjetër drogë, përdoret shumë e që është në formë të lëngët", ka thënë Blakaj.

Policia e Kosovës gjatë muajit janar të këtij viti, edhe në tetor të vitit të kaluar, pati marrë një aksion ku ishin arrestuar 26 persona, që kishte si qëllim luftimin e substancave narkotike nëpër shkollat në gjithë Kosovën.

Blakaj ka shtuar se, ndonëse mer-

ren masa parandaluese të abuzimit me narkotikë, këto nuk janë të përhershme. "Sa iu përket institucioneve, lëvizje të pakta janë në ndihmë e që intervenimet e policisë kanë qenë ditore, kryesisht të atyre që i ndjekin shitësit në afërsi të shkollave. Kjo është e pamjaftueshme", ka thënë Blakaj.

Në Kosovë nuk ka ndonjë program të veçantë permanent për

parandalimin e drogave të rinjës, posaçërisht në shkollë. Pavarësisht prej përpjekjeve të autoriteteve të rendit që të parandalohet përdorimi dhe shitja e drogave në përgjithësi dhe në mjedise në afërsi të shkollave në veçanti, organizatat joqeveritare konsiderojnë se qasja e të rinjve deri te shitësit e drogave nuk është e vështirë gjë që, sipas tyre, është shumë shqetësuese.

Vazhdojnë hetimet për incidentin në Muenster

BERLIN, 8 PRILL - Policia gjermane vazhdoi të dielën hetimet në vendngjarjen ku një burrë drejtoi furgonin përmes një turme njerëzish të mbledhur në qendrën e vjetër historike të qytetit Muenster, në pjesën perëndimore të Gjermanisë. Prokurorët ende nuk dinë motivimin e autorit të sulmit, ndërkohë që u njoftua se në apartamentin e tij u gjetën një automatik kallashnikov dhe fishekzjarr.

Policia njoftoi se të paktën dy persona u vranë dhe shumë të tjerë u plagosën kur furgoni goditi njerëzit

e ulur në tavolinat përreth restorantit "Grosser Kiepenkerl", një destinacion popullor për turistët. Aty pranë gjendet një statujë e famshme e shekullit 19 të një tregtari shëtitës të njohur me emrin Kiepenkerl. Pas incidentit, emërtimi po përdoret si hashtag në "Twitter" në lidhje me këtë ngjarje. Mendohet se shoferi i moshës 48-vjeçare vrau veten brenda në furgon. Të paktën gjashtë nga të plagosurit janë në gjendje kritike. Prokurorët thanë se ende nuk i dinë motivet e autorit të sulmit,

ndërkohë që u njoftua se në apartamentin e tij u gjet një automatik AK-47 dhe fishekzjarr.

Zëdhënësi i policisë, Andreas Bode, tha se hetuesit po ndjekin disa linja hetimi. "Sipas dëshmitarëve, mund të ketë pasur edhe njerëz të tjerë në furgon, të cilët u larguan. Po hetojmë dhe nuk kemi detaje të mëtejshme", tha Bode. Policia po hetonte edhe një objekt të dyshimtë të gjendur brenda në automjetet. Pasi vendosi lule, ministri i Brendshëm Horst Seehofer e quajti ngjarjen një "krim brutal".



Trumpi dënon sulmin në Siri

"Presidenti Putin, Rusia dhe Irani janë përgjegjës për mbështetjen e kafshës Assad. Do ta paguani", ka shkruar Trumpi, pasi aktivistët opozitarë dhe vullnetarët kanë thënë se dhjetëra persona janë vrarë në qytetin e Dumas, që gjendet në enklavën e Gutas Lindore

WASHINGTON, 8 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka dënuar presidentin rus, Vladimir Putin, shtetin rus dhe Iranin për atë që e përshkroi si "sulm i pamatur kimik", i kryer nga forcat e presidentit sirian Bashar al-Assad. Ky sulm në qytetin Duma ka lënë të vdekur dhjetëra persona, përfshirë gra dhe fëmijë. "Presidenti Putin, Rusia dhe Irani janë përgjegjës për mbështetjen e kafshës Assad. Do ta paguani", ka shkruar Trump në një postim në "Twitter", pasi aktivistët opozitarë dhe vullnetarët kanë thënë se dhjetëra persona janë vrarë në qytetin e Dumas, që gjendet në enklavën e Gutas Lindore.

Rusia dhe Irani e ndihmojnë në mënyrë diplomatike dhe ushtarake Qeverinë e Assadit në luftën civile, ku janë vrarë qindra mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur. Ndërkaq, Bashkimi Evropian ka thënë se dëshmitë çojnë te një "sulm tjetër kimik i kryer nga regjimi" në Siri.

BE-ja ka bërë thirrje për përgjigje ndërkombëtare për këtë sulm dhe i ka bërë thirrje Rusisë dhe Iranit, si "mbështetës të regjimit", që ta përdorin ndikimin e tyre tek Assadi, që të parandalojnë sulme të tjera kimike.

Ministria e Jashtme ruse ka paralajmëruar kundër çdo

veprimi ushtarak që, sipas Moskës, mund të bazohen "arsyetimet e shpikura dhe të fabrikuara", duke thënë se ndërhyrja ushtarake "është absolutisht e papranueshme dhe mund të çojë në pasoja të rënda".

Në deklaratën e postuar në uebfaqen e Ministrisë ruse, raportimet për sulmin kimik në Duma janë cilësuar si "dezinformata" dhe që kanë për qëllim të "justifikojnë sulme të mundshme nga jashtë".

Irani, po ashtu, ka dënuar akuzat për sulm kimik, duke i cilësuar si "konspiracion" ndaj Qeverisë së Assadit dhe pretekst për veprime ushtarake. "Akuza të tilla nga amerikanët dhe disa shtete perëndimore janë sinjal për një teori të re konspiracioni ndaj Qeverisë siriane dhe popullit sirian dhe janë pretekst për veprime ushtarake", ka thënë Ministria e Jashtme e Iranit.

Trumpi kishte autorizuar sulmin me raketa ndaj një baze ajrore siriane më 2017, në kundërpërgjigje ndaj sulmit me gaz sarin në një qytet në Siri, sulm për të cilin, Washingtoni e ka akuzuar Assadin.

Këshilltari i Shtëpisë së Bardhë për Siguri dhe Kundërterrorizëm, Thomas Bossert, ka thënë se ShBA-ja nuk përjashton se mund të kryejë edhe një sulm me raketa. "Nuk do të hiqja asnjë opsion nga tavolina", ka



thënë Bossert për ABC. Helmetat e Bardha dhe grupet e tjera të aktivistëve kanë thënë se me helikopterë janë hedhur mbi Duma bomba fuçi që kishin gazra toksike, duke bërë që njerëzit të ngufateshin.

Ende nuk ka verifikim të pavarur të këtyre raportimeve, të cilat media shtetërore siriane dhe Ushtria ruse i ka quajtur "të fabrikuara".

Ka raportime të ndryshme sa i përket numrit të personave të vdekur nga ky sulm i dyshuar kimik, ndërsa Helmetat e Bardha kanë raportuar se numri i viktimave është nga 40 deri në 70.

Në një deklaratë, Shoqata Mjekësore Amerikane dhe Siriane ka thënë se 49 persona kanë vdekur në sulm. Në këtë

deklaratë, po ashtu, thuhet se ata kanë pranuar më shumë se 500 raste të njerëzve që kishin probleme me frymëmarrje dhe se pacientët kishin erë të ngjashme me atë të klorit.

Më herët, Departamenti Amerikan i Shtetit ka thënë se janë duke monitoruar nga afër raportimet "shqetësuese" për mundësinë e përdorimit të armëve kimike nga forcat e Qeverisë siriane dhe Rusia, duke shtuar se ata do të mbahej përgjegjës nëse vërtetohet se janë kryer sulme me armë kimike. "Historiku i Qeverisë siriane në përdorimin e armëve kimike ndaj popullit të vet nuk vihet në diskutim", ka thënë zëdhënësjja e Departamentit të Shtetit, Heather Neurte.

Në një hetim të Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike është ardhur në përfundim se forcat qeveritare siriane kanë përdorur klorin si armë, në të paktën tri raste. Në prill të vitit 2017 më shumë se 80 persona vdiqën në një sulm me sarin, në qytetin e kontrolluar nga rebelët Khan Sheikhoun. Kjo organizatë e OKB-së për këtë sulm ka fajësuar Qeverinë siriane, por Damasku zyrtar ka mohuar se ka përdorur armë kimike.

Sulmin në Siri e ka dënuar "fuqishëm" edhe Ministria e Jashtme e Turqisë. "Ka dyshime të forta se ky sulm është kryer nga regjimi" sirian, i cili, sipas Turqisë, është i njohur tashmë në bashkësinë ndërkombëtare se përdor armë kimike.

Hungaria ka mbajtur zgjedhjet nacionale

BUDAPEST, 8 PRILL - Hungarezët mbajtën të dielën zgjedhjet legislative ku kryeministri në ikje, Viktor Orban, shihet si favoriti kryesor i cili përgatitet për të marrë një mandat të

tretë radhazi në krye të qeverisë. Në këto votime kanë marrë pjesë rreth 7.9 milionë hungarezë me të drejtë vote. Sipas sondazheve, Orban pritet të fitojë me një avantazh

prej 20 - 30 %, i cili, në vitet 2010 dhe 2014, me një fushatë të përqendruar mbi kërcënimin që përbënte migracioni, arriti t'i fitonte dy të tretat e Parlamentit.

Nga ana tjetër, opozita, që garon e përçarë, përqendroi fushatën e saj mbi fuqinë blerëse të ulët pavarësisht se papunësia është në nivelet më të ulëta (3.8 %).



(Selatin Novosella: "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", I - II, ShBPK, Prishtinë, 2013)

Një zë thirrje për zgjimin, pajtimin dhe bashkimin kombëtar të shqiptarëve

- LRBSH-ja si një bërthamë e UÇK-së

50 vjet LRBSH! 50 vjet flamur!
50 vjet thirrje për bashkimin e shqiptarëve!
50 vjet burgje. 50 vjet qëndresë.
50 vjet përpjekje, sakrificë,
flijim për çlirim, për bashkim,
50 vjet histori Adem Demaçi



Riza GREIÇEVCI

Kështu e përjetova muajin shtator 1963, në të cilin u lind një faqe e re e historisë sonë revolucionare kombëtare, me të cilën ditë e hap librin e kujtimeve historike dhe të shënuara, hulumtuesi, analisti, publicisti, historiani dhe atdhetari Selatin Novosella, në veprën me titullin "LRBSH", në dy vazhdime. Thashë dhe po them këtu edhe sot, dita e themelimit të LRBSH-së, ishte dhe mbeti një ditë e shënuar në historinë kombëtare, ishte dhe mbeti një Lëvizje që u shndërrua në një ushtri gjithëpopullore, në një revolucion gjithëshqiptar, në një bashkim dhe qëndresë gjithëpopullore, pasardhës së të cilës ishte edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ku prapë tribun i saj ishte tribun i Adem Demaçi. Veprimtaria atdhetare revolucionare e kombëtare e LRBSH-së u ndriçua shumanëshmërisht, profesionalisht, historikisht e kombëtarisht në veprën madhore "LRBSH", e para e publikuar për këtë lëvizjeje historike kombëtare e gjithëkombëtare, një shembull historik i zgjimit revolucionar kombëtar, një zë thirrje e pajtimit dhe bashkimit rreth një sofre vëllazërore e veprimtare për bashkimin e trojeve të Shqipërisë etnike, ishte, kush tjetër, pos LRBSH-ja, në ballë me strategun, tribunin, shkrimtarin, mendimtarin dhe ideatorin dhe të e frymëmarrjes së UÇK-së, Adem Demaçi.

"Ju më burgosni, më vrisni, hajt, çka po prisni, por s'mund ta ndalni luftën e popullit tim për liri!"

Vazhdon më tutje të ligjërojë, Selatin Novosella, në veprën e vet pioniere e të Lëvizjes, hulumton e vjel e sistemon fakte e dëshmi, kujtime e shembuj të pakontestueshëm që kanë përgjurmuar deri me sot nëpër raftet e mureve e të dhomave sekrete, ligjëron para

popullit, para historianëve, para AKShA të Kosovës, si historian i rryer i historisë së popullit, për një epokë të veprimtarisë revolucionare dhe kombëtare të LRBSH-së.

Shtator. Moti 1963. Në Prishtinë. Teksa kishte dalë nga terri i burgut autori i romanit "Gjarpinjtë e gjakut", Adem Demaçi, i shkruar në moshën 21 vjeçe. Në secilën faqe të këtij libri të bashkimit, të këtij libri të pajtimit, autori fton nga toka deri në vesh të Zotit të lireshin hasmëritë, hakmarrjet, të shtrihej dora e pajtimit gjithëkombëtar për të ndodhur bashkimi revolucionar i shqiptarëve, që të hapeshin shtigje për çlirim, për liri dhe për bashkim të trojeve të Shqipërisë Etnike. Moti 1959. Korbat e sojt të Shën Savës, në lëkurë të Shqiponjës, furishëm prangosen Bilbilmirin e Pranverës së lirisë, të çlirimit dhe të paqes. Bilbilmiri u kishte thënë ndër sy korbave të çakërdisur: "Ju mundeni të vrisni një shpend shqipe, vrajeni, çka po prisni, por ju bethohem se këngën, luftën, thirrjet për liri, jo kurrë s'do keni mundësi t'i shpormi nga zemra e popullit tim!"

Asnjë gjarpër s'është aq helmues sa të ketë fuqi për të helmuar krejt një popull

Vazhdojmë të mësojmë dhe të veçojmë disa nga momentet më interesante kurrë të dëguara deri me sot për LRBSH-n, që mund t'i gjeni, kur të doni, të gatshme janë, në veprën tepër të veçantë të Selatin Novosellës "LRBSH-ja". Mësojmë bashkërisht: Pas daljes nga terri pesëvjeçar i burgut, tribun i popullit s'u dorëzua. Nuk heshti. Nuk hezitoi, por thirrte bashkimin e këngës, melodive, besës, traditave, secilin qytet të Kosovës e thirrte, secilin djalë e burrë, secilën vajzë o nënë e bëri me dije: Po formojmë LRBSH-n, për pajtimin, bashkimin e shqiptarëve në një grusht! Shtator i motit 1963. Në Prishtinë. Tribun i lirisë, doli ballaballë me popullin e shtypur, të robëruar, të poshtëruar. Rreth vetes kishte rininë, drejtësinë, besën, trimërinë, kërkesat, që i dëgjuan Evropa dhe bota: Duam barazi! Duam liri! Duam të na kthehen trojet e ndara nga trupi i

Shqipërisë etnike! Duam flamurin kuqezil! Duam shkollën shqipe! Duam abetaren shqipe! Këngën dhe lojërat shqipe! Nuk jemi hamaj. Nuk jemi të egjër. Jemi njerëz. Plisbardhë. Shqiptar! Kemi gjuhën, traditat, atdheun tonë - Shqipëri! Shqiptari, më e vjetra specie gjithandej Evropës. Qe pse ne formojmë LRBSH-n, jo për të luftuar me popullin fesë dhe gjuhës tjetër, por për të shembur dhe hedhur në kokërrshpinë shtrigën e Ballkanit Jugosllavi ruso-serbo-titist, për të pasur mundësi populli i ndarë i Kosovës të bashkohet dhe të jetojë i lirë me Amen Shqipëri.

S'mund të jetë askush aq i lirë sa të mos ketë nevojë për të pasur liri

Po lindej LRBSH-ja! Motra e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit! Motra e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare! Motra e udhës revolucionare e patriotike e arsimdashësit, e prijatarit të Luftës gjithëpopullore, Hasan Prishtina, motra e Lëvizjes Kaçake në ballë me Shotë dhe Azem Galicën. Bilbilmiri në majë të majës së LRBSH-së, foli zëshëm. E dëgjuan shtatë palë qiell dhe shtatë palë tokë.

E dëgjoji Zoti, Evropa me gërshtëri në duar, e dëgjoji populli i tij: Vëllazën: Boll ma populli ynë duroi: Pashiq, Andriq, Çubrilloviq, Qosiq, Titoviq! Na shtypen. Na ndrydhen. Na poshtëruan. Nga trojet tona etnike na përzunë. Ne s'duam troje të huaja. Ne duam bashkimin! Ne duam çlirimin! Ne duam flamurin kombëtar! Ne duam lirinë! Ne duam trojet etnike të aneksuara me dhunë me izën e fuqive të mëdha të Evropës. Me fat LRBSH-ja populli im! Me fat

LRBSH-ja Kosovë! Me fat LRBSH-ja shqiptari! Shqiptarët kanë të drejtë për vetëvendosje. Dhe, jemi të bindur, se:

S'ka popull në botë aq i pasur sa të mos ketë nevojë për një atdhe

Të protestosh kur të fajësojnë pa të drejtë, ta ngrehësh grushtin para hundës së atyre, të cilët ta mohojnë punën, djersën, të drejtën për atdhe e fe, për gjuhë e liri, të mbrohesh nga ata që ta fyejnë dinjitetin, familjen, Zotin e kombin tënd, ta ngrehësh zërin e protestës fuqishëm para atyre që ditën të puthin në faqe, të përqafojnë, të thërrasin vëlla (shtatë herë në ditë përbetohen në Bibël e Kuran), kurse natën ta zënë pritën me plumbin në ballë, të rëmbesh armën kur tjetri me gërshtëri të robërisë ta rrumcallë hartën e gjeografisë së atdheut, të rrokësh pushkën, të ngjitesh ndër male si çlirimtar - kjo do të thotë se ti, o krijesë mbi tokë, nuk je kafshë, por je njeri, njeri që ndien në thelb të shpirtit peshën e rëndë të anashkalimit moral, njerëzor, shoqëror; njeri, që në gjirmën e zemrës ndien peshën e tiranisë, të robërisë, të shtypjes, të përdhunimit; njeri që ndien majë thikën në lëkurë e mish, fyerjen e gjirit, të djepit, të nderit të nënës tate; ndien cikrën e helmit duke ta trashur gjakun e trupit nga këmbët deri në tru; ndien shkeljen e fyerjen e personalitetit tënd si njeri, ndien përbuzjen e lirisë dhe fyerjen e atdheut. Mbase ne shqiptarët jemi vonuar dje për të sotmen. E tash? Të punojmë sot që të mos vonohemi nesër! Sepse: Jeta ka dy ditë bosht: Ditën e mirë dhe Ditën e keqe. Në ditën e mirë: Puno,

dashuro, ndero, ndërto, kremto, kurse në Ditën e keqe: Bashko, guxo, lufto, marsho, foli tribun i historik, foli populli, foli Kosova.

Asnjë epokë robërie s'është aq e gjatë sa të mos mundet liria me ardhë

Po të lexosh me kureshtje dhe me zemër librin "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", shkruar, fati e deshi, Zoti jep e merr, nga vetë pjesëtari i kësaj Lëvizjeje, Selatin Novosella, zor që mundesh, o mik, të mos jesh më i lumtur, më i pasur për një ditë të përpjekjeve e sakrificës së djemve e burrave shqiptarë për nderin e atdheut, të kombit, për lirinë e atdheut dhe të bindësh në mesazhin e kësaj vepre e dalë nga një epokë sakrificë e lufte për jetën, për dritën, për dijen, për gjuhën, për barazi e drejtësi, për thirrjen për pajtim, për bashkim, ke u bindur dhe i pasur lakmi, ke së paku me u përkulur para gjakut, sakrificës dhe trimërisë së djemve, burrave, vajzave, ke me u bindur, deshe o nuk deshe, sepse ideatori dhe themeluesi i një epoke të re të veprimit dhe të rezistencës, djali llapjan, Adem Dema, programin e Lëvizjes e shpërndau tepër të qartë, me thirrjen: "Liria nuk është e atyre që ia rëmbajnë popullit nga goja kafshatën e bukës, lumturinë, krenarinë kombëtare. Liria nuk është e atyre që në kohë përparimi, ndërtimi, demokracie, në kohë skamjeje, papunësie atë e përgjaken, e guajnë me gurshtetin, i poshtërojnë institucionet legale të popullit për t'i futur ato në kulmin e karrierës politike... Po, po, liria u takon vetëm, me dorë në zemër, atyre që e fitojnë me gjak lirinë, e atyre që digjen për një rrezedielli...!". (Vijon)



A doni një dekolte perfekte? Ja disa këshilla për t'ia arritur


Është ëndrra e të gjithave që të shfaqin një gjoks të plotë dhe dinjitoz, por kjo nuk është një mirazh. Këtu janë disa truke për të ngritur shpirtrat ... dhe jo vetëm!

Është kështu: dekolteja jonë ka qenë gjithmonë një nga pjesët më të rëndësishme të trupit tonë, atë në të cilin ne përquendojmë sytë dhe vëmendjen tonë. Pra, nëse nëna natyrë nuk ka qenë veçanërisht bujare me ne, të paktën në një moshë shumë të re, nuk kemi pasur ndonjë problem në lidhje me zbrazjen e gjirit. Megjithatë, pse duam ta vendosim veten në një dietë të rreptë, ose sepse e kemi ushqyer ose thjesht për shkak të moshës, - lëkura në këtë zonë është e zbratur, shtrëngohet dhe bëhet e varfër nga kolagjeni. Rezultati? Një gjoks i zbehur dhe i zbratur, i llojit që sa më shumë e fsheh aq më mirë është. Megjithatë, është e mundur që të përmbahen dëmet, pa pasur nevojë të përdorim duart e afta të kirurgëve. Këtu janë disa strategji të vogla për ta pasur në formë dekoltenë dhe për të shtuar dëshirën që ta vëmë në pah atë.

Në tavolinë: tani e dimë se mirëqenia jonë fillon me ushqimin e duhur. Edhe për dekoltenë tonë një dietë e shëndetshme dhe e balancuar është një aleat i çmuar i bukurisë. Çfarë duhet të zgjidhni? Sigurisht ushqimet që përmbajnë fitoestrogjen, substanca bimore që kryejnë një veprim të ngjashëm me atë të hormoneve femërore. Kështu që vazhdoni me kokrra integrale dhe fara liri, për soje dhe derivatet e saj si tofu, tempeth (ushqimi tipik indonezish i përgatitur nga avullimi soje) dhe miso (produkt i fermentuar i marrë nga soja, ndonjëherë i pasuruar me elb apo oriz). Po edhe për kopër, patate të ëmbla dhe shegë. Së fundmi, mos harroni bimët aromatike dhe të

egra, të tilla si majdanoz, mente, luleradhique, jamball, shafran, limon, hudhër. Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, pini çaj jeshil, sepse është i çmuar për shumë funksione të trupit tonë.

Fjalëkalimi, tonifikim! kur gjoksi relaksohet dhe kolagjeni "nuk është marrë", atëherë është koha për të lëvizur ... në çdo kuptim! Për të rivendosur ngushtësinë e gjirit të qetësuar, një ilaç i parë, i lashtë, por jo për këtë më pak efektiv, është alternimi i dushit të nxehtë dhe të ftohtë. Ne mund të shoqërojmë me ujin një masazh me lëvizje rrethore për disa minuta, duke alternuar ujë të nxehtë dhe të ftohtë. Aktivizimi i mikrocirkulacionit e mban lëkurën



elastike, duke ndihmuar në forcimin e gjoksit.

Lamtumirë yndyrës, por ... nganjëherë ne jemi kaq të lodhur për të qenë jashtë formës që jemi magjepsur nga dietat drastike, shpesh të dëmshme për shumë



simin e lëkurës: nëse indet epidermale japin rrugë, gjiri do të duket qartë më i relaksuar. Zgjidhja? Ne përpqemi që gradualisht të humbim peshën sa më shumë që të jetë e mundur, duke shoqëruar humbjen e peshës për ushtrimin fizik: ne do të kemi një gjë më të vogël, por tonik. Jo keq!

Një, dy, tre ... shkoni! Është e rëndësishme të bëni një stërvitje të shëndetshme për të mbushur gjirin e relaksuar. Një sjellje e saktë ndihmon në parandalimin e prerjes së gjoksit, sepse nëse tentoni të merrni një pozicion të lakuar, pesha e gjirit i besohet lëkurës, e cila në këtë zonë është shumë delikate dhe e cila pak a shumë jep. Kështu që ne e rrisim vetëvlerësimin tonë dhe marrim qëndrimin e mbajtësit: shpatulla të hapura, qafë të drejtë dhe të qetë. Në këtë mënyrë, gjoksi mbështetet më mirë në muskujt e gjoksit dhe është më i lartë, por kini kujdes: gjimnastika mund të përforcojë vetëm muskujt e kra-

harorit, dhe jo të rrisë volumin. Muskujt tonik të kraharorit mbështesin më mirë peshën e gjirit, duke e ndihmuar atë që të mos i japë rrugë; për madhësinë mund të bëjmë pak, për fat të keq.

Ushqyerja me gjë: e bukur dhe e rëndësishme ... Çfarë ndodh pas ushqyerjes me gjë? Përveç kënaqësisë për të parë fëmijën tonë të shëndoshë dhe topolak, pasi e kemi ushqyer për muaj të gjatë, mund të gjejmë një gjë që duket si një qese e trishtuar bosh. Zonjat e lakmueshme me një gjinj të zhveshur do të ketë më shumë gjasa që ato të jenë më të goditura nga shterimi, por përpqen të frenojnë këtë fenomen. Vishni vetëm sytjën të përshtatshme që mbështesin peshën e gjirit që, gjatë laktacionit, ndryshon formën dhe vëllimin.

Rutina e bukurisë: ndihma jonë për fat të mirë, është kozmetika. Para së gjithash, është mirë ta hidratoni dhe ta ushqeni lëkurën vazhdimisht, sepse indet e hidratuara janë më të mbrojtura nga rreziku i relaksimit. Vazhdoni pastaj me kremra të bazuara në acidin hialuronik që hidhet në thellësi. Për të kalitur indet, në vend të kësaj, ne përdorim produkte që stimulojnë formimin e kolagjenit, substanca përgjegjëse për lëkurën e fortë. Ne zgjedhim kremra specifike të gjirit bazuar në vitaminë C, të përsosur për të mbrojtur enët e gjakut dhe për të stimuluar prodhimin e fibrave elastike. Ata nuk do të jenë mrekulli, por të kujdesesh për veten është gjithnjë e rëndësishme: vetëvlerësimi na falënderon. (gazeta-Shqip.com)



Aktorja Brooke i jep fund martesës me Davidin



Aktorja dhe modeluesja Brooke Burke ka kërkuar divorc nga David Charvet. 46-vjeçarja ka paraqitur dokumentet për t'u ndarë pas shtatë vjetësh nga bashkëshorti i

saj 45-vjeçar. Siç transmeton "TMZ", çifti u martua në gusht të vitit 2011. Ata kanë dy fëmijë së bashku. Brooke ka dy edhe fëmijë nga një lidhje e mëparshme.

Zayn i fshin krejt fotografitë në "Instagram"



Këngëtari britanik Zayn Malik i ka fshirë përnjëherë të gjitha fotografitë në llogarinë e vet në "Instagram". Zayn, që numëron mbi 27 milionë ndjekës

në këtë rrjet social, e bëri këtë hap pa dhënë ndonjë arsye për publikun. Ky veprim i tij vjen një muaj pas ndarjes së tij nga supermodeluesja Gigi Hadid.



Rita Ora, koncert madhështor në Tiranë

Këngëtarja me prejardhje nga Kosova me famë botërore, Rita Ora, pas gjashtë vjetësh larg Shqipërisë, do ta bëjë rikthimin e saj me një koncert madhështor. Ylli botëror ka pranuar se do t'i argëtojë me perfor-

mancë madhështore fansat shqiptarë në Tiranë më 3 qershor. Rita Ora dha spektakël të mahnitshëm edhe në sheshin e Prishtinës dy muaj më parë me rastin e dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Kosovës.


Ben Afflecku ia realizon dëshirën 11-vjeçarit me kancer



Javën që lamë pas Ben Afflecku ka befasuar një 11-vjeçar me emrin Mukuta, i cili aktualisht po lufton me sëmundjen e kancerit. Derisa fëmija po trajtohej në Hospice Atlanta, ai shprehi dashurinë e tij për Batman. Si rezultat, stafi mendoi diçka për ta

befasuar. Aktori mori pushim nga xhirimet e filmit të tij të ri në Hawaii për të folur me Mukuta. "Një ditë e paharrueshme për Mukuta, i cili është një fans i madh i Batmanit", ka shkruar qendra e spitalit në llogarinë zyrtare në "Twitter".

10 regjisorët më të mirë të 100 viteve të fundit



Ai është një nga regjisorët më të mëdhenj që jeton sot. Çdo person që merret me prodhimin e filmave është frymëzuar prej tij që nga vitet '70. Filmat e hershëm të Tarantinos mbartnin stilin me gangsterë të Skorcezes të ndërthurur me komedi. Krijimtaria dhe origjinaliteti i tij kanë shkëlqyer në filma si: Goodfellas, Taxi Driver, The Departed (për të cilin ka fituar edhe një Oskar), Raging Bull, Casino dhe Gangs of New York, duke mos harruar filmin e tij më të fundit The Wolf of Wall Street. Federiko Fellini (Federico Fellini) Termini "Felinesk" hyri në bisedat e regjisorëve shumë kohë më parë, por nuk ka qenë kurrë më i pranishëm se tani. Çdo film shumë i bukur për nga ana e fotografisë dhe me stil, krahasohet me Felinin, sepse ai ishte mjeshtri i sekuencave ëndërruese dhe të momenteve të bukurisë gjigante. Shumë regjisorë nga e gjithë bota i kanë filmat e tij si pikë referimi në botën e madhe të kinematografisë. Ndër filmat më të njohur të Felinit mund të përmenden: La Dolce Vita, 8 1/2, La Strada dhe Amarcord. Uollt Diznej (Walt Disney) Diznej nuk është vetëm burri që ndër-

toi perandorinë më të madhe të reklamave, por ai ndikoi tek një brez i tërë regjisorësh dhe shpiku filmin modern vizatimor që njohim sot. Pa imagjinatën e Diznej, Pixar dhe Dreamworks nuk do të ekzistonin. Ai realizoi filma vizatimorë që i bënë fëmijët kudo në botë të jetonin imagjinatën e tyre. Ndër më të famshmit janë: Bambi, Borëbardha, Hirushja dhe Liza në Botën e Çudirave. Falë trashëgimisë që ai la, vazhdon prodhimi i filmave më të mirë vizatimorë edhe sot, me trilogjinë e Toy Story, Up dhe How to Train Your Dragon. Ingmar Bergman Regjisor i preferuar i Udi Alen (Woody Allen). Ingmar Bergman si një regjisor i talentuar dhe si një rrëfimtari i papërsëritshëm, solli për herë të parë përdorimin e pamjeve vizuale në tregimin e njëngjarjeje, duke i shtyrë shikuesit drejt aspektit filozofik dhe fetar të filmit. Edhe Roman Polanski shfaq shumë ndikim nga Bergman në filmat e tij. Prodhimet më të njohura të Bergman janë: The Seventh Seal, The Silence, Persona, Fanny and Alexander dhe Wild Strawberries. Huard Houks (Howard Hawks) Si një regjisor

amerikan tepër i njohur dhe i pëlqyer, karakteristikat e personazheve të tij mund të gjenden pothuajse në çdo film të analizuar me kujdes. Personazhet e femrave heroina dhe të forta ishin një shpikje e tij në vitet '30-'40 në filma si Bringing up Baby, His Girl Friday, To Have and Have Not dhe The Big Sleep. Ai gjithashtu krijoi atë që mund të shihet si prototipi i filmave Bond me përshtatjen kinematografike që i bëri romanit të Ernest Heminguej, Të Kesh a Të Mos Kesh. Prej kësaj u frymëzua Ian Fleming kur shkroi romanin e tij të parë të serive të Bond. Akira Kurosawa Ndikimi që pati Kurosawa në botën e kinemasë mund të kuptohet shumë thjesht prej filmave si Seven Samurai, Ran dhe Kagemusha. Filmat me luftëra nuk do të mund të ekzistonin pa ndikimin e arketipit të samurajit që Kurosawa e përcolli aq mirë, ku del në pah edhe kodi i nderit të luftëtarit. Filmat si The Lord of the Rings dhe Saving Private Ryan janë reminishenca të zhanrit që i dha emër Kurosawa. F.W. Murnau Nëse sot jeni në gjendje të shihni filma horror, ka vetëm një njeri që duhet të

falënderoni: F.W. Murnau, i cili është pionier i këtij zhanri dhe i ekspresionizmit gjerman në filma. Ai i dhuroi kinemasë monstrën më të njohur Kontin Drakula në kryeveprën e tij Nosferatudhe i dha jetë legjendës gjermane të folkut me Faustën e tij klasik e të heshtur. Filmat e tij më të njohur janë: Dracula, The Exorcist dhe Night of the Living Dead. Stenli Kubrik (Stanley Kubrick) Mënyra sesi Kurbik i tregonte historitë e tij përmes filmave ka qenë unike, gjë që e fut atë ndër regjisorët më të mëdhenj të 100 viteve të fundit. Ai revolucionarizoi çdo zhanër mbi të cilin punoi. Filmat Paths of Glory dhe Full Metal Jacket shfaqin dy këndvështrime të ndryshme mbi luftën dhe kanë ndikuar në çdo film lufte që është bërë më pas. Filmi Dr. Strangelove është më i errëti nga komeditë e zeza dhe gjithashtu është një nga filmat që gjatë viteve është kopjuar më së shumti pa ia dalë me sukses. The Shining i këtij regjisor është shembulli më i njohur ihorrorit. Nga ana tjetër, risia më e madhe dhe më e rëndësishme e Kubrik ishte kryevepra që bëri në vitin 2001: A Space Odyssey. Alfred

Hitçkok (Hitchcock) Mjeshtri i ankthit. Ai ishte një nga regjisorët që e kuptonte më së miri psikikën njerëzore. Hitçkok dinte ta mbante audiencën në terror dhe ankth. Mënyra sesi manovronte me kamerën ia shtonte edhe më shumë misterin filmave të tij. Gjatë viteve, stili i tij i drejtimt të një filmi është bërë "A-ja" e regjisorës. Ndër filmat më të mirë që ka realizuar janë: Psycho, Vertigo, The Birds, Real Window dhe North by Northwest. Orson Uells (Welles) E gjithë magjia e tij mund të shprehet vetëm me një fjali Citizen Kane. Ky është filmi që ai shkroi, drejtoi dhe luajti. Në kinema ekziston shprehja "para dhe pas Citizen Kane", për shkak se që prej debutimit të këtij filmi, kinemaja nuk ishte më e njëjta. I cilësuar si filmi më i mirë i të paktën 70 viteve të fundit, ai ka shpalosur teknikën dhestilin e Uells. Filma si Godfather dhe There Will Be Blood janë të dy shumë të influencuar nga Orson Uells. Dilemat që prekin protagonistët e filmave të tij, gjenden edhe te shumë filma të regjisorëve si Martin Skorceze, Pol Tomas Anderson dhe Kopola. (gazeta-Shqip.com)



Ditari sekret i Federico Fellinit

Endrrat e tij nuk mbaronin me lindjen e dritës. Mëngjesi nuk ia largonte imazhet që e kishin torturuar gjithë natën. Federico Fellini, një prej emrave më të njohur të kinematografisë kishte një zakon, hidhte në letër ëndrrat. Endrrat e Fellinit janë botuar në një libër të titulluar "Libri i ëndrrave të mia" bashkë me ilustrimet e tij, të cilat ai i kishte përgatitur që para se të vdiste. Endrrat e tij janë të shumta, në një hapësirë kohore të gjatë, nga 1961 në 1981. Por le të lexojmë disa prej tyre. Endrrat e Fellinit 1 janar 1961 Jam veshur si një romak i kohës antike dhe vetja më ngjan si një Ciceron i ngathët, gati për të hyrë në skenë. Zëri im është aq i fortë saqë po të këndoj duket se teatri do të shembet. Dhe vërtet, si në një film tmerri, shoh se teatri fillon të shembet. Puntorët e skenës mbyten nga shembja në rrënoja... Pastaj ëndërroj sikur jam në "via delle Mercedes". Bie shi.

Një prostitutë e njohur dhe e fuqishme afrohet drejt meje me çadër (është një mike e Picciocca-s që aq shumë i pëlqente ajo kurvë e shëndoshë. Përpiqem t'i tërheq vemendjen dhe i fërshellej. Por u bëra pishman që e thirra se kur u afrua ishte një kurvë plakë dhe idea që t'ia fus në gojë, më pështiroi. Ja ku jemi në shtrat në një hotel të vogël të kategorisë së tretë. Dëgjojmë zhurmën e hapave të policëve që kanë kapur vrasësin e kurvës tjetër që është vrarë pardje. E marrin me pranga nëpër shkallë. Pikas që kurva ime e ka mishin e bardhë, të butë dhe të këndshme. E pamundur ta mbaj veten. Mishi i saj më jep paqe dhe gjumë. 20 dhjetor 1961 Jam i burgosur në një burg kinez ku ka plot kurva të veshura si gejsja. Ato janë shumë sadike dhe e njohin artin më të rafinuar dhe të egër të seksit. Janë me shumë fantazi. I ndjej rreth meje ashtu të fuqishme dhe të pabesa, ndjej aromën e gojëve të tyre të hapura dhe të urritura. Ato më kafshojnë supet, në krah, duke qeshur me të madhe me sy që u shkëlqejnë. Vallë lozin, tallen? Papritur vjen Leopoldo Trieste, i cili më thotë: - Mbatnja! Do të të hanë të gjallë! Por unë vazhdoja të përballesha me ato, i bindur se gjithë kjo ishte një lojë edhe pse e rrezikshme, edhe pse e dhunshme, një luftë e vërtetë, me kamzhikë, shqelma. Arrita të dal me ndjenjën se isha treguar i poshtër pse i kisha trajtuar ashtu ato prostituta. 22 shkurt 1962 Jemi në një delegacion dhe pritemi nga Hitleri. Më kujtohet se në delegacion me ne ishte dhe Gherardi.



Është një dekor fetar, i rëndë, mbytës, si prej mortit. Mermerë të ftohtë, kripte, kupola të errta. Hitleri tutje bënte si palaço. Ai imitonte hierarkët fashistë. Na merrte për krahun shumë përzemërsisht. Në veturë me mua është dhe Titta, i cili i përgjigjet kortezisë së Hitlerit duke imituar Musolinin, Staracen... - Po në mbrëmje, çfarë bëni? - i them unë këtij gjaksori të çmendur. - Sonte do jem në meshën e një prifti të thjeshtë që do ta pushkatojmë nesër! - përgjigjet Hitleri. - Po prifti do të jetë në meshë? - e pyes unë. Ai tund kokën: - Jo. Ka ngrënë diçka prej orizi dhe s'mund të komunikojë dhe të flasë... 31 mars 1963. Profesor Bernhard i fryn anusit tim dhe pastaj fut një fije bari që të më pastrojë. 15 qershor 1963 Është ag. Xhuljeta ime ka hapur barin e saj dhe po pastron para hyrjes. - Si po shkon? - e pyes unë, - ndonjë të re? - Jo, por në vend të datës 4 ato erdhën në 7! Ajo bën aluzion për vonesën e mesturacioneve të saj. Largo hem i dëshpëruar, por ku të shkoj. S'kam shtëpi ku të vete. 19 prill. 1965 Isha i dënuar me varje. Në një terren të rëndomtë në periferi të Romës. Dikush më jep një letër të cilën pas 3-4 ditësh, një të dielë, pra ditën e ekzekutimit tim duhet t'ia jap xhelatit. Ishte

shkruar numri 69. Sa turp. Edhe për këtë ditë duan të tallen me mua? Të gjithë do të qeshin kur të paraqitem me këtë kartë. Xhelati është Gino Talamo, gjysmë lakuriq, si një lloj kllouni. Po a është i sigurtë se po të mos paraqitem, kjo s'do të bjerë në sy?... 21 korrik 1967 Si zakonisht Giulietta është bërë sa një grusht nga e pira. Unë qaj dhe nuk e mbaj dot veten. Jam në ankth, kam keqardhje dhe klith: "S'do të vij më në shtëpi! Nuk dua të të braktis dashuria ime por s'mund të të shoh më në këtë gjendje. Po iki përgjithmonë!"... Vallë për këtë arsye dua ta lë? Para syve, tani kam një album të fotografive të jetës sonë të për-bashkët, fotot e fejesës, të ditës së martesës, etj. Por të gjitha këto i shoh në një tis dëbore. Dëbora ka rënë në të gjitha episodet e jetës sonë. Qaj dhe zgjohem me zemrën tepër të trishtuar. 15 shkurt 1975 Vazhdoj të ëndërroj se ngado që shkoj bëj «kaka» që qelb me një erë të keqe. I bëj pis brekët, këmishën. Madje dhe gravata më njolloset. Veshur me bizhame, në dorë mbaj një top «kaka» që sapo e kam nxjerrë. 13 tetor 1966 Në një nga valixhet, Xhuljeta ka fshehur kufomën e Villalonga-s. Jemi në një hotel të madh duke ndrruar dhomën. Kam frikë se mos punonjësi i

hotelit dyshon në diçka. Giulietta është moskokëçarëse, edhe pse është ajo vrasëja e Villalonga-s. Duket sikur e ka harruar këtë histori dhe merret me dhomën e re. Valixhja është vendosur në banjo. Të nesërmen vjen era e kufomës. Duhet ta zhdukim patjetër. Ndoshta do dal natën, me valixhen në dorë nëpër errësirë e mjegull për ta hedhur në Tamise, apo diku jashtë qytetit. I bie rrotull hotelit për të gjetur aty afër ndonjë urë. Është dhe babai im që do të më ndihmojë. Jam i qetë dhe kjo gjë duket më e lehtë, por kur doja të kthehesha në qytet ngatërrova rrugën. Rrugës pyes dikë dhe ai më thotë se është nga Bolonja. Më duket se kam dy kufoma për të hedhur. 10 dhjetor 1966 Alberto Sordi është akuzuar për një krim të rëndë: 10 vjet burg. Në korridorin e burgut që kundërmon erë të qelbur, e shtrëngoj Sordin për krahësh dhe përpiqem ta ngushëlloj: "Nuk mund t'i shpëtosh fatit. Duhet ta pranosh këtë ngjarje të jetës. Ti s'mund ta shmangje atë..." 28 maj 1967 Xhuljeta është në kuzhinë dhe i thotë Ugo Tonjazit se unë kam ndryshuar mendimin për të dhe se nuk më përshtatet për filmin e ardhshëm. Pak më vonë Tonjazi më telefonon, por unë bëj gjoja se mund të ketë ende shpresë

për të, meqë nuk kam kurajo t'i them të vërtetën. Por ai qan. - Pse qan? - i them unë. - Sepse ti s'do të më marrësh në film. Tashmë jam në një avion me motorrë që bëjnë zhurmë. Avioni nis. Ku shkoj? Në Londër, Milano? Ndoshta në Londër. Papritur vendos të mos shkoj. Ju lutem atyre të zbres. Hotesa e avionit më jep valixhen, pallton dhe në portën e hapur është shkallarja, por sapo dal, pasagjerët të tjerë vijnë me vrap pas meje. Hotesa i pengon dhe më bllokton padashur që të dal. Në këtë çast avioni lëviz. Shkallarja largohet.

Vallë kam kohë të hidhem poshtë? Endrra ndalon këtu. Jam në një avion në lëvizje. Po të hidhem mbase e kap shkallaren... 21 korrik 1967 Si zakonisht, Giulietta është bërë sa një grusht nga e pira. Unë qaj dhe nuk e mbaj dot veten. Kam ankth, keqardhje dhe klith: S'do të vij më në shtëpi! Nuk dua të të braktis dashuria ime, por s'mund të të shoh në këtë gjendje të dehur. Po iki përgjithmonë! Vallë për këtë arsye dua ta lë? Para syve tani kam një album me fotot tona të jetës së për-bashkët, fotot e fejesës, të ditës së martesës. Por të gjitha janë nën një tis bore. Ka rënë dëborë në gjithë episodet e jetës sonë. Qaj dhe zgjohem në zemrën plot trishtim. (gazeta-Shqip.com)



					Autor: GAZMEND MORINA	FUTBOLLISTI BELG NË FOTO (MANCHESTER CITY)	JONI ME NGARKESË NEGATIVE	TËRËSI E TRUPAVE USHTARAKE QË VENDOSËN NË NJË QYTET	AGIM CANA	NJË (turq.)	DHOMË E BURRAVE (sh.shq.)	LLOJ METALI	DEPARTMENT TRADE INDUSTRY	EPOKA E RE	DIKTATOR SOVJETIK	I ÇAKUT MË TË POSHTËM
					AVENTURIER	○								DY BASHKË- TINGËLLORE ZANORE		
					MUNGESA E ACIDITETIT	○										
					NIKEL, REOMIR	○			PUË ALKOOLIKE, QË NXIRRET NGA MUSHTI I RRUSSHIT I GJYMTON					ALEN NURI LLOJ GURI I ÇMUAR NË NGJYRË TË UJIT TË DETIT (shq.)		
					KËNGËTARE ... MALAJ	○				"TETOVA" FILLESTAR			LETRARI ASLLANI AMPER, TON, AZOT			
					E FILLOVA (bised.)	○					LAKESË "IRLANDA"					
					REKRUTI NË PERANDORINË OSMANE	○						KËNGËTARE E JONA (Nofka) POLITIKANI KROAT SANADER				
					BASHKËT.	○	VEGËL MUZIKORE TELEVISION I YNI MUZIKOR NË RRJETIN KABLLOR							BASHKËT. E NJËSUAR, E BASHKUAR		
EPOKA E RE	BESIM I VERBËR TE FATI	GAZ QË SHKAKTON PLAGË NË LËKURË (shq.)	THEMELUESI I TURQISË MODERNE MUSTAFA ATATURK	UNIVERSITY LIMERICK ORCHESTRA	EPOKA E RE	FLEGËR BASHKËT.	○				BASHKËT. QYTET I LASHTË NË ILIRI		BRITMË E LOPËS HUÇ, VES			KOPJIM
LLOJ PEME FRUTORE E VENDEVE TË NGROHTA (shq.)					AKTORI CRUISE SHTET NË AZI	○		TOROLLAKU EMËR YNI DJALI								
THIRRJA QË I BËHET I TURMËS					MAKINË E POSAÇME QË PUNON ME LËNDË DJEGËSE (shq.)	○						PUNIM I ARËS ZANORE				
QË KA TË BËJË ME TEMËN NË FJALË					SKICË PARADË USHTARAKE (sh.pashq.)	○				PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT KAPËRDIJ						
LLOJ PAPANALLI				"P" në mes të dy "A" HENDEK I THELLË E I GJERË, QË ËSHTË HAPUR PËR TË UJITUR ZHANËR I MUZIKËS		○	ZANORE NJË KONTINENT		HAITI, OHIO			MËRI REGJISORJA KALLABA				
KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM						○			NJËRA NGA SIPËRFAQET KUFIZUESE TË NJË SENDI QYTET I MADH NË ITALI				KUNDREJT I VJETËR KASOLLE E VOGËL KU MBAHEN SHPENDËT			
ISMET TOTO			BASHKËT. SHKRIMTARJA KAMBERI		PESHQIR (sh.shq.) REGJISORI HOLLIVUDIAN ... BURTON	○				FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART	RIFAT KUKAJ KËRKESË PËR TË RISHQYRTUAR NJË VENDIM GJYQI			ERMELINDA MEKSI TENISTI AMERIKAN ANDY (shqip.)		
EMNAKJA E EMRIT ZINET						○	PËRTËRITËS ASSOCIATION ZEN INTERNATI.								NAIM ISMAJLI	BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN
ZANORE		GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE STUHI E FORTË ME ERË DHE SHI						TRAJNERI ITALIAN XHOVANI MA JEP								
NDËRTIM ME TË CILIN RRETHOJMË OBORRIN				PJESA MË E YNDYRSHME E QUMËSHITIT MARC ANTHONY					INDIUM, ELEKTRON PRUJË I HUNËVE			ALBANOLOGIA DËRHAM SKUADËR (sh.pashq.)				
EPOKA E RE	SHTEG, RRUGË E NGUSHTË BARI I THARË				VEND KU NGARKOHEN E SHKARKOHEN ANIJET "RISAN"					HUMORIST I YNI AKTORJA AMERIKANE ... RYAN					ZANORE RROGOZ I VOGËL (shq.)	
LLOJ SHALE PREJ DRURI ME DY KAPTEJ (shq.)						○	BËRTHAMOR VËLLAI I MADH						KALIUM, ALUMIN RRALLË (Lat.)			
TITULL OTOMAN				GRIMCOVA (bised.) OLIVIER MARTINEZ			ZANORE AKTORI MONTAN		FUTBOLLISTI BAJRAMI (TWENTE) ORGANIZATA E SHËNDE-TËSISË					NORA ISTREFI DY BASHKË- TINGËLLORE		
ISH KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË FATOS					KAPITULL I FUNDIT I NJË VEPRE LETRARE ZANORE						AJKA E SHOQËRISË BASHKËT.					
PAGJAKËSI							NGADALË, JO SHPEJTI (krah.)					KËNGËTARI ASLLANI				

E rrallë

Pesëvjeçari paratë që kishte kursyer i jep për luftën kundër kancerit

Një pesëvjeçar ka vendosur t'i japë mjekut që ia kuroi mamanë nga tumori kursimet që kishte mbledhur. Ai ka thënë se këto para do të shkojnë në fondin për luftën kundër kancerit. 45 qindarka kanë qenë kursimet e pesëvjeçarit në total, jashtëzakonisht pak për ta luftuar sëmundjen e kancerit, por që merr vlerë shumë më të madhe kur vijnë nga një fëmijë.



FOTO E DITES



Udhëtarët shëtisin në urën më të gjatë prej druri që lidh dy brigjet e Liqenit Taungthaman në Mandalay. /AP/

E jashtëzakonshme Zbulohet tempulli greko-romak 2 200 vjeçar në Egjipt

Mbetjet e një tempulli greko-romak 2 200 vjeçar janë zbuluar në shkretëtirën perëndimore të Egjiptit. Arkeologët kanë zbuluar skulpturën e kokës së një njeriu dhe dy statuja luani gëlqerore afër Siwa Oasis, vend që mendohet se është vizituar nga Aleksandri i Madh. Mbetjet datojnë



midis shekullit të dytë para Krishtit dhe shekullit të tretë pas Krishtit.

BARSOLETA E DITËS



Ofiqari: A pranoni ta ndryshoni statusin tuaj në "Facebook" nga "single" në "married"?
Nusja: - Po.
Ofiqari: I lus kumbarët të afrohen dhe të klikojnë 'like'.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
 Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
 Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
 Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
 Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Sot do të keni një fillim të mbarë të ditës pasi do të prirni të ndihmoni këdo që ka nevojë për ju. Miqtë dhe partneri janë të lumtur që ju kanë pranë.



DEMI

Bëni mirë të tentoni që të lidhni marrëveshje jashtë shtetit sepse kanë më shumë mundësi financiare. Do të arrini të bëni dallimin midis dy personave afër jush.



BINJAKËT

Sot nëse tregoni gënjeshtra do të zbulohen shumë shpejt. Mundohuni të jeni të qartë në gjërat që ju nevojiten për një projekt.



GAFORRJA

Jeni në paqe me veten sot dhe me personat që keni pranë. Bazohuni në informacionet që keni për të zgjidhur një çështje të komplikuar.



LUANI

Në sytë e njeriut të zemrës duhet të jeni të përkryer dhe kjo ju bën të jeni sa më të vëmendshëm dhe në detaje ndaj vetes tuaj.



VIRGJERESHA

Jeni të ndrojtur dhe mjaft të rezervuar në çfarëdo situatë që ju paraqitet sot. Temperamenti juaj nuk ju lejon të bëni eksperimente.



PESHORJA

Momente të së shkuarës ju vijnë në mendje por pa qenë aq shumë thelbësore në vendimet tuaja të së tashmes. Një surprizë e këndshme do t'ju befasojë.



AKREPI

Megjithëse me buxhet të reduktuar kohet e fundit, pasuria e brendshme është aq e bollshme sa ndiheni personat me të pasur në planet.



SHIGJETARI

Çdo gjë përreth jush buzëqesh sot sepse edhe ju vetë i falni buzëqeshjet pa kërkuar asnjëherë asgjë në shkëmbim. Sot do të mbyllni një kontratë fitimprurëse.



BRICJAPI

Miqësitë e reja do t'ju tregojnë që jeni persona që tek të tjerët përçoni veçse mirësi dhe energji pozitive. Kjo gjë do t'ju shoqërojë edhe në ambientin e punës.



UJORI

E kotë që përpiqeni të fshiheni pas gishtit. Sot në çdo moment do të krijoni tensione që nuk janë shumë të nevojshme.



PESHQIT

Keni vendosur të jeni besnik të ideve tuaja fillestare dhe do t'i mbronni ato pa bërë kompromise. Kjo gjë mund t'ju penalizojë në disa raste.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	VILLARREAL - ATHLETIC BILBAO	GG3+	LEIPZIG - BAYER LEVERKUSEN	3+	MOREIRENSE - BOAVISTA	1
-------------------	------------------------------	------	----------------------------	----	-----------------------	---

Fitojnë Llapi dhe Vëllaznimi, Drita nuk e lëshon kreun



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 PRILL - Llapi dhe Vëllaznimi të dielën kanë shënuar fitore me rezultat 1-0 në ndeshjet ndaj Gjilanit, përkatësisht Drenicës. Por, lidere e klasifikimit vazhdon të jetë Drita e Gjilanit, e cila e mposhti të shtunën Besën e Pejës (0-2). Derbi i kësaj xhiroje të shtunën në mes të Feronikelit dhe Trepça '89 përfundoi pa fitues 0-0. Me rezultat të bardhë ka përfunduar edhe ndeshja në mes të Vllaznisë dhe Lirisë së Prizrenit. Sot (e hënë) zhvillohet ndeshja e fundit për këtë xhiro në mes të Flamurtarit dhe Prishtinës.

Vëllaznimi - Drenica 1-0

Derbin e skuadrave kuqezi e fitoi Vëllaznimi ndaj Drenicës me rezultat 1-0. Lojtari më i mirë i Vëllaznimit në ndeshjet e fundit, Lekë Vula, në minutën e 24-t shënoi për 1-0, pas një gabimi të dobët të portierit Flamur Neziri. Kuqezinjtë nga Skenderaj patën mundësi për ta barazuar rezultatit në minutën e 68, por Genc Hamiti nuk ishte i saktë nga penalltia. Duhet cekur se nga minuta e 14 Vëllaznimi luajti me një lojtar më pak, pasi me të kuq u ndëshkua Altik Muhaxhiri. Tash Vëllaznimi ka 35 pikë dhe është vetëm një pikë larg Drenicës, e cila renditet në poz-

itën e tetë.

Llapi - Gjilani 1-0

Fitore para tifozëve të vet ka shënuar Llapi, i cili në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Besianë e mposhti Gjilanin (1-0). Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse katër minuta pasi filloi pjesa e dytë, llapjanët arritën te goli i epërsisë, të cilin e shënoi Mirlind Daku nga penalltia. Ishte sulmuesi Daku ai që u pengua në zonën e rreptësisë nga mbrojtësi Ylber Kastrati. Vendësit luajtën me një lojtar më pak nga minuta e 77, kur u përjashtua Ilir Blakçori. Pas kësaj fitoreje Llapi ngjitet në pozitën e katërt, me 42 pikë, derisa Gjilani mbetet në pozitën e shtatë, me 39 pikë.

Feronikeli - Trepça '89 0-0

Derbi i kësaj xhiroje i zhvilluar të shtunën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas përfundoi me rezultat 0-0. Mysafirët patën raste të mira shënimi në pjesën e parë, por Otto John nuk arriti t'i shfrytëzonte. Rastet nuk munguan as në pjesën e dytë, por fitues nuk pati. Në këtë mënyrë ndeshja ku skuadrat drejtohen nga trajnerët e Shqipërisë, Sulejman Starova dhe Gugash Magani (Trepça '89), përfundoi në paqe.

Besa - Drita 0-2

Drita e Bekim Isufit duket se e ka seriozisht garën për titull, sepse kjo skuadër arriti edhe një tjetër fitore si mysafire ndaj Besës së Pejës (0-2). Fillimisht në minutën e 21-të realizoi Haxhi Neziraj pas asistimit të Xhevdet Shabanit, derisa tetë minuta më vonë rezultatin final 0-2 e vulosi Astrit Fazliu. Me këtë fitore Drita ka arritur në kuotën e 50 pikëve dhe aktualisht ka 6 pikë më shumë se Prishtina, e cila të hënën luan derbin ndaj kundërshtarit lokal, Flamurtarit.

VALA SUPERLIGA

Vëllaznimi - Drenica	1-0
Llapi - Gjilani	1-0
Feronikeli - Trepça '89	0-0
Besa - Drita	0-2
Vllaznia - Liria	0-0

Të hënën takohen:
Flamurtari - Prishtina

Tabela

1. Drita	50 pikë
2. Prishtina	44
3. Liria	43
4. Llapi	42
5. Feronikeli	40
6. Trepça '89	40
7. Gjilani	39
8. Drenica	36
9. Vëllaznimi	35
10. Besa	18
11. Flamurtari	14
12. Vllaznia	14

Në xhirin e radhës takohen: Trepça '89-Vëllaznimi, Drenica-Flamurtari, Prishtina-Besa, Drita-Vllaznia, Liria-Llapi, Gjilani-Feronikeli.

LIGA E PARË

Bashkimi (K) - Kosova (P)	5-1
Hajvalia-Onix	0-2
KEK-u-Dukagjini	5-1
Fushë Kosova-Vushtrria	0-0
Ramiz Sadiku-2 Korriku	0-0
Balkanli-Rahoveci	2-0
Kika-Ferizaj	0-0
Vitia-Trepça	2-0

Tabela

1. KEK-u	52 pikë
2. Balkani	51
3. Vushtrria	49
4. Ferizaj	44
5. Onix	40
6. Fushë-Kosova	38
7. Ramiz Sadiku	32
8. Vitia	31
9. Bashkimi (K)	31
10. 2 Korriku	30
11. Dukagjini	29
12. Trepça	26
13. Kika	24
14. Rahoveci	23
15. Hajvalia	23
16. Kosova (P)	7

SHKURT

Karaqi i sjell Kosovës medalje nga Maroku

Alvin Karaqi e ka fituar medaljen e bronzit në garën prestigjioze Premierë Liga që po mbahet në Rabat të Marokut. Karaqi në duelin e parë humbi nga garuesi egjiptian Elma Sry Ahmed, por në repasazh për medaljen e bronzit, Karaqi u rikthye fuqishëm duke fituar tri duele ndaj garuesve Grilon Kenjj (Francë), Arenas Pablo (Spanjë) dhe në finale për medaljen e bronzit ndaj garuesit të Ukrainës, Chobotar Valaeri me rezultat 5:0.

Loriana Kuka, e artë në Turqi

Loriana Kuka e ka fituar medaljen e artë në turneun e xhudos Grand Prix në Antalya të Turqisë. Për ta rrëmbyer të artën Kuka e mposhti xhudisten nga Ukraina, Anastasya Turchin. Në gjysmëfinale, Kuka e kishte mundur xhudisten ruse, Nikiforova. Loriana është fituese e medaljes së artë në kategorinë -78 kg. Ky ka qenë një fundjavë triumfuese për Kosovën në garat e xhudos, pasi tri vashat e tjera, Nora Gjakova, Distria Krasniqi dhe Fjolla Kelmendi, i siguruan vendit medalje në Antalya.

Muriqi nuk ndalet, shënon dy gola

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, ka arritur të shënojë dy gola për skuadrën Rizespor në ndeshjen kundër Eskisehirsporit. Llogarinë e golave ai e hapi qysh në minutat e parë të ndeshjes, kurse nuk u vonua shumë dhe në minutën e nëntë arriti ta shënojë edhe golin e dytë. Skuadra e tij arriti ta fitojë ndeshjen me rezultat 4-1, kështu duke kryesuar Ligën e Parë të Turqisë me 59 pikë gjithsej të grumbulluara.

"Page" në derbin e Madridit

MADRID, 8 PRILL - Ka përfunduar baras, 1-1, derbi i Madridit në mes të Realit dhe Atletico, me dy gola që janë shënuar në harkun e katër minutave në fillimin e pjesës së dytë. Atletico mbetet në vendin e dytë të La Ligës, me katër pikë më shumë se Reali i vendit të tretë, por plot 11 pikë pas Barcelonës, që fitoi 3-1 ndaj Leganes, të shtunën në mbrëmje

dhe marshon drejt titullit kampion. Pas pjesës së parë që u mbyll pa gola, Cristiano Ronaldo kaloi në avantazh Realin në "Bernabeu", pas krosimit të Gareth Bale, duke realizuar golin e 23-të në këtë kampionat, gjashtë më pak se golashënuesi më i mirë Lionel Messi. Por i pabesueshëm është fakti që Ronaldo ka shënuar në të dhjetë

ndeshjet e fundit në të gjitha veprimtaritë për një total të pabesueshëm prej 20 golash në këto takime. (24 gola në 13 ndeshjet e fundit). Gjithsesi, avantazhi i "Los Blancos" zgjati vetëm katër minuta, pasi francezi Antonie Griezmann vuri baraspeshën për të besuarit e Simeones. Me rezultat 1-1 përfundoi ndeshja derbi e La Ligës.



Besa dhe Prishtina vazhdojnë të fitojnë

PRISHTINË, 8 PRILL - Besa FamGas e Prishtina kanë vazhduar të fitojnë në Superligën A të Kosovës në hendboll. Në kuadër të javës së 23-të, Besa fitoi ndaj Zhegrës me rezultat 35:18, kurse Prishtina e mposhti Dritën me rezultat 43:30. Besa është e para me 44 pikë, ndërsa Prishtina e dyta

me 42 pikë. Drita mbetet e katërta me 24 pikë, kurse Zhegra mban vendin e pestë me 19 pikë. Vëllezërit Tahirukaj shënuan së bashku 11 gola për Besën, ndërsa pesë herë realizoi Muqolli, kurse Shaqiri shënoi shtatë herë për Zhegrën. Te Prishtina më efikas i fitoren ndaj Dritës

ishite Fetahu me nëntë gola, kurse Selmani realizoi 11 herë për ekipin gjilanas. Fitore të thellë ka shënuar edhe Kastrioti. Të shtunën në Ferizaj, Kastrioti e mposhti Vëllaznimin me rezultat 34:24. Kastrioti është i treti me 26 pikë, kurse Vëllaznimi i gjashti me 19 pikë.



Dominimi i Bayernit, pikante nga kampionët e Gjermanisë

MUNCHEN, 8 PRILL - Kampion absolut, dominues në futbollin gjerman. E demonstroi një statistikë, mbi të gjitha, që nga viti 1995 e deri më sot në 20 raste nga 23, skuadra nga Muncheni ka përfunduar kampionatin ose në vendin e parë ose në të dytin. Blerjet e verës së kaluar, James Rodriguez, Sule, Tolisso dhe Rudi, fitojnë titullin e tyre të parë në Gjermani, ndërsa Ribery të tetin, duke arritur kështu legjenda si Scholl, Kahn, Schweinsteiger dhe Lahm, që janë më fitimtarët në historinë e futbollit gjerman. Siguria matematikore për titullin në Gjermani nuk kishte ardhur kurrë më parë në javën e 29, por në dy raste kampionati është fituar më parë, në javën e 28 në 2013-n dhe në të 27-n në 2014-n. Ka dhe një detaj tjetër interesant, ky është kampionati i 12 radhazi, që nga 2000 e deri tani, që Bayerni nuk e siguron titullin në shtëpinë e tij. Në vitin 2015 fitoi pa luajtur falë disfatës së Wolfsburgut kundër Gladbachut, në rastet e tjera e ka siguruar trofeun në transfertë, ashtu si dhe këtë të shtunë ndaj Augsburgut që, të paktën, është në Bavari. Janë plot tetë lojtarët e Bayernit që kanë koleksionuar të paktën 1 prani në 6 kampionatet e



fundit radhazi të fituar nga bavarezët: Alaba, Boateng, Martinez, Myller, Neuer, Rafinha, Ribery dhe Robben, raporton "Superpost". "Yjet" e Bayernit nuki mungojnë, por këtë sezon, ndryshe nga ata të mëparshmit, ka një protagonist absolut. Kur Jupp Heynckes u ul në stolin "bavarez", skuadra ishte në vendin e dytë me pesë pikë më pak se Dortmundi, por në 22 javët në vazhdim Heynckesi fitoi plot 58 pikë nga 66 të mundshmet, duke "asfaltuar" gjithë kundërshtarët. Heynckesi edhe këtë vit, ashtu si në 2013-n, mund ta synojë triumfin e trefishtë, duke qenë se Bayerni është në garë dhe në Ligën

e Kampionëve dhe në Kupën e Gjermanisë. I shkëlqyer edhe me kontributin i James Rodriguezi, gjithmonë vendimtar në ndeshjet e rëndësishme. Në fazën e parë, kur skuadra ishte ende në veshitë, e udhëhoqi në përballjet e drejtpërdrejta me Schalken, Leipzigun e Dortmundin. Edhe këtë të shtunë shënoi golin e titullit. E pamundur në fund të mos citosh Robert Lewandowskin, që me 26 gola në kampionat, jo vetëm se është kryegolashënues i turneut, por ka shënuar dyfishin në krahasim me ndjekësin më të afërt, Petersenin e Freiburgut dhe, falë tij, Bayerni sot është kampion.

Duranti nuk mjafton për Warriorsin, Houstoni ul ritmin

HOUSTON, 8 PRILL - Pasi e kanë siguruar vendin e parë dhe të dytë në Konferencën në Perëndim, Houston Rocketsi dhe Golden State Warriorsin ulin ritmin në ndeshjet e fundit të sezonit të rregullt në NBA. Në "Toyota Center" të Houstonit kryesuesit e renditjes u ndalën me rezultatit 102-108 nga Oklahoma City Thunderi. Paul George dhe Russell Westbrook ishin inspiruesit e këtij suksesi të Thunderit me nga 24 pikë, ndërsa Carmelo Anthony shtoi edhe 22 pikë të tjera për Oklahoman. James Harden, pavarësisht prej humbjes së Rocketsit, rezultoi më i miri mbi parket me 26 pikë, 9 asistime dhe 4 rikuperime. Plot 41 pikë realizoi Kevin Duranti përballë New Orleans Pelicansit, por Golden State pësoi humbjen e dytë radhazi 120-126. Për Pelicansin spikati Anthony Davis me 34 pikë dhe 12 rikuperime, ndërsa Mirotic dhe Holiday shtuan respektivisht 28



dhe 25 pikë për miqtë. Denveri po bën gjithçka për t'ia rrëmbyer vendin e tetë në ndeshjet e fundit Minnesota Timberwolves. Nuggetsi shkatërroi 115-134 Los Angeles Clippersin, në një përballje ku spikati Bartoni me 31 pikë. Milwaukee zhvilloi një periudë të

katërt fantastike për ta mposhtur 102-115 New York Nicksin falë formës së mirë të Bledsoes dhe Middletonit, që shënuan nga 22 pikë. Chicago Bulls i dorëzua 96-124 ndaj Brooklyn Netsit, ndërsa San Antonio Spursi-Portland Trail Blazersi u mbyll 116-105.

SHKURT

Pogba: Nuk mund t'ua falnim titullin rivalëve

Mesfushori Paul Pogba ka qenë vendimtar në ndeshjen derbi të Manchesterit pasi ka realizuar dy gola për Unitedin, duke ia siguruar fitoren skuadrës së vet 3-2 ndaj rivalëve të Cityt. Dy gola në dy minuta për Paul Pogban, që u bë protagonist dhe i rëndësishëm për skuadrën e Jose Mourinhos, duke ia prishur festën ekipit të Cityt, që në fund të pjesës së parë udhëhiqte 2-0. "E dimë se skuadra e City nuk është një ekip që mbron mirë, që nuk pëlqen të mbrojtë, ndaj vendosa të sulmoj më shumë zonën kundërshtare. Nuk doja në asnjë mënyrë ta humbisja këtë ndeshje, pasi t'i jepnin titullin kampion skuadrës së City do të ishte si një vendim për vdekje për tifozët tanë. Ndaj reaguam dhe treguam se sa vlejme", ka thënë Pogba.

"The Sun": Kloppi zëvendëson Zidanen


Real Madridi raportohet se e ka vendosur Jurgen Kloppin zëvendësues potencial të Zinedine Zidanes. Trajneri gjerman ka transformuar "Të Kuqtë" që kur kaloi më 2015, duke udhëhequr ekipin në formë të mirë në kampionat dhe Ligën e Kampionëve. Realin në anën tjetër është 15 pikë prapa lideres, Barcelonës dhe "The Sun" raporton se ekipi po bën gati zëvendësuesin potencial të Zidanes nëse sivjet dëshon në Ligën e Kampionëve. Raporti shton se Kloppi vlerësohet nga "Mbretërit" për lojën ofensive.

Bayerni, 100 milionë euro për Ter Stegenin

Bayern Muncheni do të kërkojë të nënshkruajë me portierin e Barcelonës, Marc-Andre ter Stegen, këtë verë, raporton "Don Balon". Kampionët e Bundesligës janë të shqetësuar për shëndetin e Manuel Neuerit, i cili ka humbur shumicën e sezonit me lëndime. Dhe gjigantët "bavarezë" shpresojnë se një ofertë 100 milionë eurosh do ta bindë Barcelonën për ta lëshuar 25-vjeçarin. Në fakt, portieri i Barcelonës është ai që zë pozicionin e Neuerit në ekipin kombëtar gjerman. Sidoqoftë, ideja e klubit "katalanas" nuk ka qenë kurrë të shesë një nga lojtarët më të mirë të saj. Kujtojmë se klauzola e çlirimit të portierit nga kontrata aktuale në "Camp Nou" është 180 milionë euro.

Juve kërkon Simeonen dhe Grizmannin nga Atletico

Skuadra e Juventusit mund ta humbë trajnerin Masimiliano Allegri në fund të këtij sezoni, duke qenë se edhe një herë tjetër dështoi në fitimin e Ligës së Kampionëve (ka edhe 90 minuta për të luajtur me Realin, por 3-0 nuk përmbysat lehtë), po mendon ta përforcojë skuadrën e sezonit të ardhshëm me një goditje dyshe, në radhët e Atletico Madridit. Sipas së përditshmes madriline "AS", trajneri i "bardhekuqve", Diego Pablo Simeone, shihet si kandidati më i mundshëm për ta zëvendësuar Masimiliano Allegrin. Grinta e argjentinasi, por edhe njohja e mirë e Serisë A, ashtu sikurse e argjentinasi dhe amerikano-latinëve që ka Juve në grup, në krye me Dybalen e Higuainin, mund t'i japë një tjetër vull "Zonjës së Vjetër", për ta tentuar "poltronën" e Evropës. Por, në të njëjtën kohë, afrimi në skuadër i Simeones mund të bënte që së bashku me të, në Torino të fluturonte edhe Antoine Griezmann. Ylli i Atletico është shumë i lidhur me trajnerin e tij dhe Juventusit është gati ta paguajë klauzolën prej 100 milionë eurosh që francezi ka me klubin aktual dhe të dy së bashku, Simeone e Grizmanni, t'i rinovojnë idetë dhe në të njëjtën kohë ta fuqizojnë lojën e bardhekuqinve. Për momentin, asnjëra nga palët nuk është prononcuar.



FTESË PËR TENDER

Banka Ekonomike Sh.A. Prishtinë, fton subjektet e Interesuara të paraqesin ofertat për:

- 1. FURNIZIM ME BANKOMATË TË RINJË PËR TËRHEQJE (CASH OUT) DHE BANKOMATË PËR TËRHEQJE DHE DEPONIM (CASH IN)**
- 2. PËRMIRËSIM – (Upgrade) TË BANKOMATËVE EKZISTUES**

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të jenë me TVSH
- specifikacionin detal teknik
- në ofertë duhet të ceket afati i garancionit si dhe afati i liferimit
- dokumentacionin e nevojshëm mbi TVSH-në dhe regjistrimin e biznesit
- referencat - kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më **24 Prill 2018 në ora 15:00.**

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nena Tereze p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com


Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku dy muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për bankomatë" duhet të dorëzohen në lokalet e e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nena Tereze p.n. dhe t'i drejtohen Shërbimit të Prokurimit.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në çdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A	info@bekonomike.com
Sheshi Nena Tereze p.n	Tel. +383 (0) 38 500 500
10000 Prishtinë, Kosovë	Fax: +383 (0) 38 500 507




Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

Prishtinë

Shijo Pranverën me...



Jaffa Champion

C.nr.350/2017.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm Div. Civil, Gjyqtari Jonuz Bugari, në çështjen juridike të paditësit Roland Holgye i lindur Krasniqi nga fshati Dejnë, Komuna e Rahoveci, të cilin e përfaqëson Rasim Hoti, Avokat nga Rahoveci, kundër të paditurës Anita Holgye nga Republika e Sllovakisë, tani në adresë të panjohur, për shkak të zgjidhjes së martesës, më datë 16.03.2018. merr këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurës Anita Holgye nga Republika e Sllovakisë, tani në adresë të panjohur, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm **Ismet Kërçagu**, Avokat nga Rahoveci.

Përfaqësuesi i përkohshëm në këtë procedurë, i ka të drejtat dhe obligimet e përfaqësuesit ligjor. Këto të drejtat dhe obligimet përfaqësuesi i përkohshëm do të i kryen gjeri sa e paditura Anita Holgye, ose përfaqësuesi i saj të paraqitet në gjykatë, respektivisht kur Organi i Kujdestarisë i QPS-së në Rahovec e njofton gjykatën për caktimin e kujdestarit.


Aktivndimi do të iu dërgohet përfaqësuesit të paditësit, përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës si dhe të shpallet në Gazetën Zyrtare e Republikës të Kosovës, në një nga gazetatat të përditshme ditore në Kosovë, në tabelën e shpalljeve të Gjykatës si dhe një kopje do të i dërgohet Organit të Kujdestarisë të QPS-së në Rahovec.

A r s y e t i m

Të paditurës Anita Holgye, në këtë çështje juridike i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm, me propozimin e përfaqësuesit të paditësit Avokatit Rasim Hoti, meqenëse e paditura gjendet në adresë të panjohur në Sllovaki. Arsyerat për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm janë të cekura në dispozitiv të aktvendimit.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 79 al. 3 pika a, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, më datë 16.03.2018.



Gjyqtari i trupit
Gjyqtari
Jonuz Bugari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.


CN.nr.247/2017

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtarin Fatmir Aliu, me sekretaren juridike Ibadete Hasani dhe përkthyesen Xhevide Selmani, në çështjen jokontestimore të propozuesit **Radivoje (Milorad) Radisavljeviq** nga Beogradi rr. "Vëllezërit Rankoviq" nr.90 në Serbi, për shpalljen e personit të zhdukur dhe atë babain e tij Milorad Radisavljeviq, e ish me vendbanim në fsh.Revuç, Komuna e Podujevës, pas mbajtjes së seancës jopublike, në prani të propozuesit me dt.08.02.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se personi Milorad Radisavljeviq, i lindur me dt.04.01.1935 nga babai Milan dhe nëna Radinka në fsh.Revuç, Komuna e Podujevës, e ish me vendbanim e fundit në fsh.Revuç, **ËSHTË ZHDUKUR** në muajin Prill të vitit 1999 në fsh.Revuç, Komuna e Poduevës.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CN.nr.247/2017 të dt.08.02.2018



Gjyqtari:
Fatmir Aliu

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, prej marrjes së një kopje të aktvendimit, ankesa i adresohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe deponitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkohet për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkohet një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkohet 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

URGJENTISHT KËRKOJ BANESË PËR ZYRE ME QIRA
Në qendër të Prishtinës, kërkohet banesë me qira, për zyre. Hapësira 80-100m2.
Kati i I- deri në katin -III-
Tel: **044741155**

Lajmërohen bashkëpronarët e ngastrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërxhaliu ka shprehur dëshirën që të ashë një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërxhaliu.

LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastrioti" në Matiqan të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m2. Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-509-077.

Urgjentisht kërkohet një shtëpi me qira në Prishtinë. Shtëpia duhet të jetë e veçantë, duhet të ketë 5 ose 6 dhoma gjumi. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel 049-472-770

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

